

F/c 0-58



ISBN 99927 38 01 4

BIBLIOTEKA
CISORZALE
ISTENES

167

N1

SHTEPIA BOTUESE "NAIM FRASHERI"

BIBLIOTEKA E TRADITËS



Përgatiti për shtyp: Arian Leka

Korrektori: Nasi Lera

Kopertina: Florimont

© i këtij botimi

Shtëpia Botuese "Naim Frashëri"

Tiranë

1998

fan
s. noli
—
albumi

BIBLIOTEKAT KOMUNALE ASTUSSA
147

Comune - Provincia

Shtëpia Botuese "Naim Frashëri"

POETI
FAN S. NOLI

(Vështrim Panoramik)

I

Jo një herë, në dhe të largë, më pat zënë malli për vjershat e Fan S. Nolit. Ato disa strofa, që i dinja përashta e që ia thesha kur e kur vetë-vetes ose shokëve, nuk m'a shuanin dot këtë etje. Për këtë mall - mall largimi - duhej një vëllim i cili të përbledhë brenda gjithë veprën poetike të gjermësotme të Plakut të Amerikës. Dhe një vëllim i tillë nuk është shtypur gjer tanë. Dyke kuptuar se edhe të tjerë, dashuronjës të fjalës se Fan S. Nolit, veçanërisht të rinjtë, ndiejnë një mall të njejtë për këtë vepër, po shtyp sot këtë përbledhje. Vjershat i mbodha nga fletore dhe të përkohëshme të ndryshme ose nga dorëshkrimet e miqve dhe adhuronjësve të Poetit.

Me këtë rast vjershavë origjinale dhe shqipërimeve botërisht të njoitura u janë shtuar disa fragmenta karakteristike të nxjera nga librat e shqipëruara prej tij dhe të cilat mbajnë vulën specifike të verbit Nolian. Kësilloj, shqipërimeve nga Edgar Allan Poe (*Annabel Lee* edhe *Korbi*) edhe nga Henry Wadsworth Longfellow (*Skënderbeu*) i rishtypur me disa gabime në antologji shkolllore të Ministrisë së Arsimit, u janë

shtuar disa vjersha të nxjera nga veprat e William Shakespeare-it: *Qaj, shelk, o shelk i zi* (Kënga e Ofelisë); *Kur isha i ri* (Kënga e varr-mihësit); *Të rrash a të mos rrash* (Monologu i Hamletit); *Vinj t'a varros, jo t'a lëvdonj Qesarin* (Fjala e Mark Antonit) nga Jul Qesari; *Rrith gjak, rrith gjak, Atdhe i mjerë*, nga Makbeth; *Male pyje plot me fletë*, *Këtu dergjet*, nga Don Kishoti i Cervantes-it e disa Rubaji nga Omar Khajami. Me këtë mënyrë u zgjerua rethi i atyre që quajmë vjersha të Fan S. Nolit.

Për një zgjerim të tillë u-desh, pa fjalë, një kohë e gjatë shqyrtimesh - e punimesh - për gjetjen e tekstit, kopijimin e rikopijimin e tij e sidomos përbashkimin e disa fragmentave që kështu të mundim të kemi njëfarë prodhimi të ri, unitar. Bje fjala, përfshirë pasur vjershën *Rrith gjak, rrith gjak, Atdhe i mjerë* u-muarr e u-bashkuan disa fragmenta nga ligjërat e Makdaf-it dhe të Rossi-t, bujare të Skotlandës (Makbeth). Gjithashtu u-bashkuan Rubajit' e ndryshme përfshirë mbledhur, pak a shumë, së bashku *Rubajit' e Lirisë*, *Rubajit' e Miqësisë*, *Rubajit' e Korësirave*, etj. Kështu, përbledhja që ka në dorë lëçitësi nuk është një reprodhim mekanik dhe automatik, si shumë ribotime të tjera të tregut, po një vepër e menduar dhe e punuar, muaj me radhë, prej atij që mori barriën e botimit.

Titullin *Mall e Brengë* e kam sgjedhur si një që më duket se pasqyron fryshtësin e kësaj përbledhje. Me këtë rast të përbledhjes të veprave në një vëllim do përpinqem të heq disa vija të përgjithshme, përfshirë cilësuar vepren e Nolit dhe veçanërisht vepren e tij poetike.

II.

Kompleks dhe gjenial është personaliteti i Fan S. Nolit. I pajisur me një kulturë të gjerë, të mbledhur si

përfshirë, në rrithana kafe kundërshtare, e në një jetë kafe të turbulltë, njohës i kafe gjuhzave, I kafe dishiplinave të ndryshme, i kafe klimatave shpirtërore, me një sensibilitet shpirtëror kafe të shvilluar, ay mban brenda tij edhe njatë dhuratë të madhe që u jep Filla-fjala është tija - njerëzve: dhuratën e krijesës. Gazetar, theolog, orator, dramaturg, historian, kritik, letrar e gjithëmonë poet, edhe në këto vitet e fundit, kompozitor, Fan S. Noli ka sjellë, në gjithë degat ku ka punuar një sulm të tijnë, një verb të panjohur, madhor.

Edhe, në të gjitha këto dhurata, gjithë ky veprim i tija, prej dyzet e ca vjet, vetëm në shërbimin e një idealit: idealit Shqiptar. Një ideal, si t'i thuash, shoqëror-kombëtar: gjithëmonë shoqëror e gjithëmonë kombëtar.

Mundim të themi se Fan S. Noli është i pari shkrimitar dhe kritik Shqiptar i cili sjell në shkrimet e tij - veçanërisht në hyrjet e librave - pikëpamjen shoqërore edhe mbështetje sociale. Për këtë vlefshje të lëçiten veçanërisht hyrjet në vëllimin e parë të Don Kishotit (mos e kërkoni në Bibliotekën Kombëtare të Tiranës, se e kanë grisur, zyrtarisht, qe kur ardhë libra), në *Armiku i Popullit* dhe në *Jul Qesari*. Gjithë kjo frymë e pat shtyrë Fan S. Nolin të na japë dhe shqipërimin e *Kasolles* nga Blasco Ibanez.

Vëzhgoneshi i arthmë që ka marrë barrën e shqyrtimit të veprës Noliane, mbasi të ketë plotësuat bibliografinë e tija (që s'e kemi të plotë), duhet ta thellojnë në gjithë cilësitet edhe saqet që patmë cekur ma sipër. Për të patur një vijë të përgjithshme e një portret të Peshkopit-Poet, ky vëzhgim duhet të përbledhë vepërimin e tij si:

GAZETAR.

Dyke filluar nga viti 1908 në fletoren *Drita* të Shahin Kolonjës, *Kombi* të Sotir Pecit, *Djelli* të Vatrës, *Revista Adriatike*, *Republika*, etj., me emrin e vetë ose me pseudonimet *Theofan Mavromati* (përfshirë shkruesit Ali Baba Qyteza, etj).

ORATOR.

Ky vepërim duhet shqyrtuar në të dy aspektet e tij kryesore: a) *Oratori kishëtar* ose *predikonjësi* i fjalës së Zotit, më purë si prift dhe më vonë si peshkop; b) *Oratori politik*, për fjalimet e mbajtura përpara popullit edhe përpara Parlamentit gjatë Dhjetorit, 1924. Gjithë këtu duhet shqyrtuar edhe vepërimi i tij retorik për mbrojtjen e të drejtave Shqiptare përpara Lidhjes së Kombeve.

SHKRIMTAR KISHËTAR.

Me shqipërimin, në kohën e duhur, të librave kishëtare *Triodi*, *Shërbesë e Javës së Madhe*, *Libra e Shërbesave të Shenja të Kishës Orthodokse*, *Pesëdheteri i Vogël*, *Lutjesorja*, dhe *Vajtimet e Përmivarrëshme*, Imzot Theofani jo vetëm se krijoj veglën e parë që hapi rrugën drejt Autoqefalisë kishëtare, po edhe farkoi terminologjinë Shqiptare për Kishën Orthodokse. Këto shqipërimet e tija janë edhe sot, e do të janë për shumë kohë, librat e shërbimit të shënji të Kishës s'oni.

HISTORIAN.

Me veprën e tij *Historija e Skënderbeut*, Noli nika dhënë të parën veprë shkencore dhe gjatë më sot të vëtëmen, mbi Herojn' e Krujës dhe mi historin' e Shqipërisë në periudhën e tij.

SHQIPÉRONJËS.

Veprimtaria lettrare si shqipëronjës mbetet një nga kontributa e tij më të vlefshme në letrat e Shqipes. Kujtojmë këtu shqipërimet e gjermësotme: nga William Shakespeare: *Othello*, *Hamlet*, *Makbeth* edhe *Jul Qesari*; nga Henrik Ibsen: *Armiku i popullit* dhe *Zonja Ingra e Ostrotit*; nga Miguel de Cervantes: *Don Kishoti i Mançës* (5 vëllime); nga Blasco Ibáñez: *Kasollja*; nga Omar Khayam-i: *Rubairat*; nga Longfellow; *Skënderbeu*; dhe nga Poe: *Annabel Lee* edhe *Korbi*.

KRITIK LETRAR.

Me shqyrtimet e tij mbi veprat *Don Kishoti*, *Jul*

Qesari, *Armiku i popullit*, *Ingra e Ostrotit*; *Hamlet*, *Makbeth*, *Othello*, edhe *Rubairat*, Fan S. Noli shfaqet përpara botës Shqiptare si i pati kritik dhe esthetik i vendit. Veprat e sipërme janë modele të gjalla analizimi, gjykimi dhe interpretimi, edhe pasqyrojnë kthjellësinë e mendjes edhe ngrohtësin' e shpirtit të tij, e sidomos kulturën e tij të gjërë. Përsëritim këtu, ato që patnë thënë më sipër, se në tre studimet e para Fan S. Noli sjell në pikëpamje shoqërore krejt të re re në letrat e Shqipes. Shprehim me këtë rast mendimin, po të jetë se gjendet një editor, për shtypjen e një vëllimi të veçantë të këtyne veprave të tij kritike, kaqe të nevojshime për edukimin letrar, esthetic, dhe stilistik të gjeneratave shkolllore.

MUZIKANT.

Në vitet e fundit dyke studiuar muzikën si nxënës i thjeshtë i Konservatorit, na dha veprën "*Hymnare*" (Boston, Mass., 1936) që përmban edhe disa kompozimet e tija.

POET.

Fan S. Noli i shfaqet botës Shqiptare edhe si poet, poet i vërtet i një inspiracioni të ri. Aty krijoj poezinë dinamike, të metaforave të forta, të rrepta, mbi të cilën do të zgjuteri më shumë në radhët që vijojnë.

III.

Vjersha e Fan S. Nolit është esencialisht vjershë politike-patriotike. Satirike këtu - *Marshë i Barrabajt*, *Bismilah Tridhjet Seneja, *Kënga e Monarkisë*; elegjiakë aty - *Thomsoni* dhe *Kuçedra*, *Elegji për Luigj Gurakuqin*, *Shpellë Dragobisë*; simbolike përtetj - *Shën Pjetri në Mangall*, *Moisiu në Mal* edhe apollojetike-retotike më tutje - *Hymni i Flamurit*, *Jepni për Nënë* - ajo është e mbetur, në thelbën e vetë, vjershë politike-patriotike. Rrugë fortë shkelur në Shqipëri kjo e vjershës*

patriotike-politike, por jo gjithëmonë me tonin madhor të vitalitetit dhe të originalitetit. Dhe së këndejmi ay prodhim mediokriteti me tonalitet fals, banal, mërzitës, që çduket apo u-duk, i hedhur përtëj prej shijes e gjyqit spontan të lëcëtësit, si hidhen levezhgat prej valës së detit në zall. Kësaj kategorije vjershërimi Fan S. Noli i dha shprehje të re, energjismë, dinamismë, dhe e bëri të trojë.

Si fill e lëndë kjo vjersha e Nolit e ka mburimin në ndjenjën e dashurisë së Atdheut dhe në ngjarjet politike që i pat rrojtur e vojtur aq vetë, pas kryengritjes së Qershorit. Është pra një poezi personale. Dhe kaqe thellësishët rrojtur e vojtur këto ngarje-politike, këto ngritje dhe përblysje, këto sulme e gremina të përgjakura me gjak vëllaj, sa ushëtimat e tyre, fantazmat e tyre e kanë ndjekur vite me radhë me dhembje dhe tortura. Këto dhembje e tortura, të përsëritura me procesin e kujtimeve, të rikujtimeve të shtuara në mërgime, gjetnë së fundi shprehje në vjershë. Dhe përmjet syresh Fan S. Noli bëhet poet, pa i thënë vetes poet.

Kronologjikisht ky vepërim i tij fillon me një vjershë të rastit: *Thomsoni edhe Kuçedra*, e shkruar në Korrikun e vitit 1914, pas vrasjes së Thomson-it në Durrës prej rebelave. Evokon ketu, me brithmë këngë e me sulm retorik: *Te ura, te ura! Vraponi o burra...* dhe me simbole të marrë nga bota e prallave, *Dolli kuçedra e errët nga nata; Me katiérqind krahë, lubi' e Dovletit*, atë ftyrë heroike dhe bujare të Kolonel Thomsonit, *Kalorës i huaj, që vdiqe për ne*, i vrarë prej vetë dorës s'oni. Thamë, kjo vjersha e tij e parë, kazuale, ka sulm retorik dhe vargje që na japid, intuitivërisht, përshtypjen e zhurmës së detit që rrëh pa pushuar, me rrëptësi, anët, ose si zhurma e bombardimit të një kështjelle.

Gjithë e rastit dhe gjithë me sulm këngë (është bëre apostafat për t'u-kënduar) është ajo vjersha-brithmë, *Jepni për Nënën*, e shkruar në Amerikë, për Fushatën e Qershorit, kur u-mblodhnë të hollat e nevojshme për

mbrojtjen e të drejtave Shqiptare në Konferencën e Paqes së vitit 1919.

Që të dyja këto vjersha janë të fazës së parë të vjershërimit. Agon këtu, me impetuozitet, temperamenti poetik e vullkanik i Nolit. Midis vargjesh e fjalësh pak a shumë tipike, të kohës, çquhet një damar i ri poetik dhe veçanërisht një fjalor i ri, kuximtar, një metaforismë e fortë. Ky damar i ri poetik do shohëm se do të zhvillohet më vonë dyke zbritur në thellësi, pikërisht në thellësirat e ndërgjegjes, (*Shën Pjetri në Mangall edhe Moisiu në Mal*).

Me të dy elegjite binjake të kushtuara Luigj Gurakuqit dhe Bajram Currit, i pari martir i një atentati, i dyti dëshmor në luftë, shokë besimi e qëndrimi politik me Poetin, hymë në veprën madhore të Nolit. U themi elegji këtyre dy vjershave binjake, po kjo nukë duhet të kuptohet si një e një me tonin elegjiuk klasik, lakrimogjen, i resignuar, po si një ligjëratë katilinare, sulmonjëse, e thënë mbi trupin e tyre. Një ushëtimë e larguar, si intencion, mund t'i afrojë me fjalimin e Mark Antonit nga vepra *Jul Qesarë* e Shakespeare-it. Largohen sojesh përmjet mënyrës indirekte që përdor Shakespeare-i për lartësimin gradual të ftyrës Qesariane dhe mënyrës direkte, me sulm katilinar, që përdor Noli. Stil e mjet diplomatik, përtëj; sulm heroik, këndej. Gurakuqit, viktimi atentati, i portretizon virtutet psikike (*Spirit i bardhë si dëbora; Gajë-mjaltë zemërhekur*); Bajram Currit, dëshmor në luftë, heroizmin e tij: (*Vërdi dridhej, ay mbeti; Dif Dragoj i Dragobisë*). Nga kontraste morale dhe vepërimi midis tij dhe atyre që e lëftonin dhe që e vranë ngrihet lartë ftyra serafike e Luigjit. Ja dhe vargu:

*Se të deshte kur s'të deshni,
Se të qante kur të qeshni,
Se të veshte kur të çveshni.*

Nga qëndrimi si luftëtar në fushat e lustrave, që ka patur në qëndrimin e idealit, përjetësohet ftyra heroike e Bajramit. Me ngjyra që di t'i dallojë ndjesija e tij e hollë, Noli e quan Luigjin: *Vëlla (Nën' o moj mbaj zì për vilanë)*; Bajramin: *Baba (Po ti vdiqe, or Baba)*.

Jo vetëm përmjet shprehjesë e fjalësh Poeti di të kryejë portretin e heronjve, po edhe përmjet atmosferës së tingëllit, të efektit akustik të vjershës. Në elegjinë e Luigjit të tre vargjet e para të çdo strofe kanë rimë të njëllojtë, trokaike, me tingëll të mbyllur, statike, të lodhur (ranë -vranë - shanë; deshmin - qeshnin - çveshnin, etj) që të bluan e të shtyp në dhembje, kurse vargu i fundit ka një tingëll të thekësuar, që mbaron me një jamb.

Kemi këtu, në të gjitha vargjet e fundit të çdo strofe fjalët: tradhëtor, dëshmor, trimëror, hor, edhe liberator, me efekt tingëllonjës vertikal, që ngjitet, kundrejt efektit orizontal të rimave të tjera. Pikerisht këto vargjet e fundit, përfundonjëse, janë ato që zoterojnë vjershën me përshtypjen e lëvizjes për të dalë nga rrëthi statik i dhembjes e për t'u ngjitur lart, si ngjitet tymi i temjanit ndaj shpirtit martir. Kësaj lipset i shtojmë, për të shtuar atmosferën e dhembjes, brithmën "Nëno moj" të përsëritur katër herë në pesë strofa si edhe përdorimin e dativit etik (na i ranë, na e shanë, na i thanë, m'a qaj) afersi e embël, e lidhur me fjalët "nënë" dhe "vëlla". Vargu i fundit "Ky vigan Liberator" është vargu i apotheozës.

Tri trajta përdor poeti në elegjinë e Bajramit, dyke shkuar nga njëra në tjetra me një naturalismë e thjeshtësi të plotë. Kemi trajtën e tregimit në vetën e tretë (strofa 1, 2, 3 edhe 7), trajtën e vetës së dyte (strofa 4 dhe 6) edhe trajtën impersonale (vargu i parë i strofës 5). I jepin këto një varacion tonesh. Lipset nënëvjuar këtu se me gjithë përdorimin e dëndur të rimbës femërore e cila, përgjithërisht, është më pak energjike, elegja e Bajramit, përmjet sulmit edhe shprehjeve metaforike qëndron lart fort si vjershë dinamike.

Midis dy elegjive motra që kujtuam më sipër edhe dy vjershave të një torturë psikike (*Shën Pjetri në Mangall* edhe *Moisiu në Mal*), me të cilat do merremi më poshtë, qëndron vjersha satirike *Marshi i Barrabajt*. Mburimi i saj është një kazuistikë personale në lidhje me ngjarjet politike të Qershoret e të Dhjetorit 1924. Hyn në këtë vjershë një atmosferë apokaliptike dhe një invektivitet epithetesh zhurmnjëse të një ashpërsije pa shoq në letrat e Shqipes. Për të plotësuar fjalorin e tinguje të fortë që i mungon shqipes, dhe veçanërisht Toskërishtes, Noli përdori këtu një varg të gjatë fjalësh Arabishtë, Turqishtë, dhe Persishtë, të asimuluara prej Shqipes. Kujtjmë syresh *allalla, rezil, katil, turfanda, teptil, dallkauk, kopuk*, si edhe një nga strofat e satirës:

*Në budrum, nëpër llom' e kufom' u-mallkofsh,
Në skëterrën, katran e tiran, u-harbofsh,
Me tamtam e allarm e me nëm'u-shurdhofsh,
Në zëndan mbretërofsh: Hosana, Barrabat*

Një rrëke e rreptë që zbut tatëpjetë me zhurmë shurdhonjëse, një artileri e rëndë fjalësh e shprehjesë, një fërtymë mallkimesh apokaliptike - ky është Marshi i Barrabajt.

Pas kundër-revolucionit të Dhjetorit Fan S. Noli u-desh t'a lerë Shqipërinë... E fillojmë kësilloj këtë kaptinë sepse vjershat që do të analizojmë, *Shën Pjetri në Mangall* edhe *Moisiu në Mal*, e kanë gjenezën pikërisht nga kjo ngjarje politike. Shokët që kish patur, disa i ranë pas, disa jo. Mbetnë në vënd, të lidhur prej tokës dhe jetës tokësore, dhe u-bashkuan me mundësinë. Dalengadale, pastaj, u-shpérndanë edhe ata që i patnë rënë pas në orët e para të mjerimit. Kësilloj, atëherë kur u-hap proçesi i tij, shumica - edhe mbështetës - i mohuan shoqërinë, ideologjinë dhe luftën e përbashkët.

Kjo i ka ngjarë dhe munt t'i ngjasë kujt-do të

munduri, që nga Krishtu e këndej. Po Noli i sh poet dhe si i tillë e ndjeu thellësisht mjerimin, se mbeti i vetëm, me kurorën e gjembave mi krye. Dhe u-mendua pikërisht në Ay, në dymjë vjet përparrë tij pat mbajtur mi krye një kurorë të tillë, i mohuar dhe i vetëmuar prej shokëve, në atë grimën e rëndë të gjyqit e të dënimit. Dhe kësilloj na dha këtë vjershë me titull Biblik e me simbolle biblike, po me brendi satirike - politike.

Këtu mohimi dhe trathëtja e shokut konsumohet dyke patur gjithëmonë të zgjojtur ndërgjegjien e trathëtisë. Dhe së këndejmi ay torturim i brendëshmë, njëkohësisht Dostoevsky-an edhe Poe-an, dhe, përmri këto të dyja, Nolian. Vjersha ka një arkitekturë specifike: një hyrje dhe tri grupe simetrike, sicili prej tyre dyke përbajtura akuzimin, mohimin dhe satirën. Të tri strofat e para përbëjnë hyrjen. Strofa e katërt, lidhjen midis hyrjes edhe trupit të vjershës:

Strofa e parë është e përshkrimit të tufanit, e dyta e gjyqit të Krishtit, dhe e treta e satirës politike. Vjersha fillon me një përshkrim të tufanit të jashtmë, fizik, (*frym e çfrym veriu...*) përfshirë prej atmosferën e tufanit të brendshmë, të torturës psikike të mohonjësit. Këtu duhet nënëvjuar shprehjet fillestare energjike, “*frym e çfrym*” që jepin, ato vetë, përmjet efektit tingëllonjës, intuicionin e përsistencës. Gjithë përfshirë nënëvjuar është prezencia e shkronjës r në pesë nga gjashtë fjalët e vargjeve të parë si dhe fjalët *veriu, ngrin mërdhin i ziu*, sukcesion tingësh të njëjtë, mënyrë fort dendur e përdorur prej Nolit, përfshirë t'i shtuar dinamismën vjershës. Karakteristika e saj, e sidomos e gjithë vjershave të Nolit, është pikërisht përsëritja e tingëjve, e fjalëve, e shprehjeve - një i afër ky përfshirë krijuar një atmosferë dhembje, torture dhe nervoziteti, dhe të cilin e ka mësuar nga ay mjeshtwri i mbaruar i dhembjes që është Edgar Allan Poe.

Strofa e dytë është, si e thamë, e gjyqit të Krishtit, simboli i gjyqit të Poëtit vetë. E treta strofa është ajo e satirës politike. Simbolik në vargun e dytë, “*Roma do*

t'a kryqëzonje”, bëhet krejt politik në të tretin dhe në apendicin e tij: “*Triumfon Legaliteti, Dhe Laneti*”.

Vjen pastaj strofa që bën lidhjen e hyrjes me trupin e vërtetë të vjershës. Kjo është dhe filesa e torturës shpirtërore e shokut mohonjës.

Dhe fillojnë së këndejmi të tre grupet e strofave, sicili me akuzimin, mohimin dhe satirën.

Si pat qenë shkruar dhe thënë, tri herë pyjet Shën Pjetri në se edhe ay është shok i atij që e gjykojnë brenda dhe që të tri herët, sa vjen me më shumë energji e mbasë me brutalitet, si një që nga frika dhe dhembja e madhe nukë zoteron nervat, Shën Pjetri “*proteston*” dhe “*mohon*”. Ja dhe vargjet që i radhosim simetrikisht - akuzim e mbrojtje - po të cilat, brenda tekstit, janë të ndara prej vargjeve me ngjyrë satirike.

Mohimi i parë:

Dhe një shërbëtore i tha;
 - “*Je dhe ti një nga ata!*”
Po Shën Pjetri proteston,
E mohon.

Mohimi i dytë:

- “*Nga ata je!*” i hot ajo.
E mohon Shën Pjetri: “Jo!
As e njoh, as e kam parë,
Moj e marrë.”

Mohimi i tretë:

Thot’ ajo: “Je, mos gënje!”
Pjetri e mohon me be:
“Jo përfshirë Zotin, moj aman.
S’jam e s’jam!”

Dhe pas çdo mohimi, fellohet dhembja dhe tortura e brendëshme, për dobësinë e jashime. Vjen pastaj, gjithë si pat qenë e shkruar, kënga e këndezit që i kujton mohimin dhe trathëtinë. Ja dhe vargu, që përsëritet, simetrikiشت, tri herë:

*Kuspull mi mangallin mblidhet
Po djek dorën dhe përdridhet
Seç këndon bandill këndezi
Nga qymezi.*

Shprehja “bandill këndezi” këtu, edhe “u-kol këndezi” e strofës së katërt vesh një robe ironije. I treti kuptim i përbajtjes është *ay i satirës* që vjen pas çdo akuzimi dhe mohimi.

Pas mohimit të parë:

*S'ka e s'ka si heroizma,
Edhe si idealizma,
Por kur dimër del behari
S'ka si zjarri.*

Pas të dytit:

*Shkab' e shkëmb me poz'e fjalë,
Seç na dolle shkrumb e galë,
Në je trim këtu tregoje,
Shko, shpëtoje.*

Dhe pas të tretit, kur ndahen krejt të dy botët:

- *Simon Pjetër, Bar Jona,*
Këshiu ndahet kjo dynja:
Kryqi andej, këndej buxhaku
Dhe allçaku.

I plotësuar procesi i mohimit dhe trathëtisë, vjersha mbyllitet me një jeremiadë.

*Seç vajton Shën Pjetri hidhur,
Lesh-lëshuar, duar-lidhur,
Tri her'e mohoj pa gdhire
Faqe nxirë.*

Si nga stili i saj lapidar, ashtu dhe nga kompleksi i përbajtjes, vjersha *Shën Pjetri në Mangall* është një nga prodhimet më të vjera të Shqipes.

Gjithë biblike është thema e vjershës *Moisiu në Mal*. Këtu, vetëm në pesë strofa, Fan S. Noli na përshkuar tragjedinë e Krye-Profetit të Israelit, të dënuar prej Zotit vetë - për fajet e popullit të tij, “*skillevér, bij skillevësh*” që s’ë meritojnë lirinë, se nuk e duan - të mos e shohë tokën e shenjtë, të premtuar prej Atij vetë dhe për të cilën pat vojtur, pat luftuar, dhe pat ëndëruar dyzet vjet. E shohim këtu Moisinë në fazën heroike, optimiste të ngjitjes në Malin e Shenjtë të Israelit.

*Ngjitet përpjetë, Malit të shkretë
Krye-Profeti, trimi me fletë...*

Pastaj në fazën e foddjes, si kapteni kulmin, dhe të tronditjes, të frikës që gjendet përpara Jehovit, Zotit të gjithë botëve, dhe përmë të gjitha: Zotit të popullit të Profetit:

*Zëndron me frikë, pret i tronditur...
Arrin në majë, lart i kapitur,*

Edhe kur Jehovi, që “*flet prej një reje, me zë rrufeje*”, ligjëron dënimin e tmerrshmë të mos shkelë tokën e premtaur, se janë “*skillevér, bij skillevësh*”, që nuk e meritojnë lirinë sepse nuk e duan (këtu Moisiu është Noli vetë dhe populli i Israelit vetë populli Shqiptar), shëmbet përdhe i dërmuar:

*Krye-Profetit dita i ngryset
Dhe shpirt-këputur përdhe përmbyset*

Dhe së këndejini, nga toka, (*me lot në sy, me zemër tē ngrirë*) i lyp mëshirë:

*Pse kaqe gjatë, Zot, m'arratise?
Pse më përplase, më përpelise?
Pse shpresën dyzet vjet m'a ushqeve
Dhe sof ni'a preve?*

Kështu dhe këtu mbaron vjersha, më një vajtim e me tri pyetje që mbeten pa përgjigje, sepse gjyqi kish vendosur. Dhe të le kjo strofa e fundit, gjithë shpirtin, në një dhembje të vagët, që nukë mbarohet kurë.

“Moisiu në Mal” na hap kësilloj, radhë pas radhe, vizione të madhërishme dhe ushëtima dhembjesh në shpirt. Dhe kjo tragedija e Moisit të Israelit simbolizon atë të Plakut të Amerikës. Sepse edhe ky, prej afro dyzet vjet u-pat ushqyer në shpresën e Tokës së Shenjtë dhe të Shqipërisë së lirë që nukë mundi ta gëzonjë dot.

Dhe nërmjet këtyre valëve malli dhe mërgimi, na dha këtu vjershë turmbullonjëse. Po ka këtu, në dënimin e Jehovit një reze drite për të arthmen: Jehovi nuk dënon gjithë Israelin - pra gjithë popullin - po vetëm gjeneratën e parë, të pleqve “skllevër bij skllevësh”. Për risinë, Toka e Shenjtë mbetet e hapur, si mbetet edhe Shqipëria jonë...

Nuk do ishim të plotë në analizimin e kësaj vjershe po të mos kujtonim një tjatëri vjershë botërisht të njojur, gjithë mbi Moisinë e Israelit, pra të endur me një lëndë të njëjtë: *Moïse* prej Alfred de Vigny, të cilën e lartëson aqë fort Benedetto Croce. Afrohen që të dyja këto vepra - poemë i Alfred de Vigny-ut dhe vjersha e Nolit - sepse kanë si lëndë një rrëfim biblik: Ngjitja e Moisit në Mal, për të folur me Zotin. Largohej njëra nga tjatra përmjet tonit, përmjet shvillimit edhe përmjet përfundimit.

Poemi i poetit Frëng ka ondulacione lirike, si

përshkrimi i perëndimit të diellit në kadrin idilik të pyjeve me ullinj, të fushave të bleruara dhe këngëve me harpa, kurse vjersha e Nolit ka sulm heroik. Në të parin Moisiu është kur ngjitet në Mal dhe bisedon me vetë-veteri se nuk do shkelë Tokën e premtuar; në të dytën, jo. Pas Vigny-ut Moisiu vetë, i lodhur, i dëshpëruar nga punët e popullit të tij, i lutet Zotit t'a shkarkonjë nga barra e udhëheqjes së këtij populli; kurse pas Nolit, vetë Zoti i jep dënim, përfajet e të tjerëve, sepse, sipas Biblës, Zoti dënon birin përfajet e prindit edhe më tej. Si vjershë lirike, poemë i Vigny-ut është i qetë, si vjershë epike-politike kjo e Nolit është nervoze. E para ka 116 vargje, e dyta vetëm 32, me gjithë apendice. Ndyshimi midis tyre është pra substancial, si trajtim, si konceptjon edhe si ton. E shkruar me një gjuhë të një populli të math e të njojtur, kjo vjersha e Nolit t'oni do ish një vepër e njojur botërisht. Po neve a nukë na mjafton që e kemi në gjuhën tonë?

E veçuar nga këto të gjitha mbetet ajo vjersha lapidare e kushtuar Flamurit, me të cilën fillon kjo përbledhi. Ne e quajmë Hymini i Flamurit, këtë monolith të qëndrimit dhe të përmanencës Shqiptare, ballë përballë me kombet e tjerë, që iu-patnë derdhur si rebeshe, gjatë historisë, kësaj toke dhe këtij populli. Na jep këtu Fan Noli, vetëm në dhjetë vargje, me atë stilin e tij të rreptë, burrror, njëkohësisht lirik dhe epik, përshkrimin edhe simbollet e Flamurit:

*O Flamur gjak, o Flamur shkabë,
O Vënd e Vatr'o Nën'e Babë,
Lagur me lot, djegur me flagë,
Flamur kuq, Flamur zi!*

përshkrimin e sinthezës historike të Kombit, një i vetëm përmjet Flamurit:

*Flamur, që lunt Shën Kostandinin,
Bashkon Islamn'e Krishterimin,
Flamur bujar për Njerëzit!*

si edhe qëndrimin, përmanencën Shqiptare, në të
kaluarën dhe kurdoherë:

*S'të tremb Romani, as Venecjani
As Sërb-Dushani, as Turk-Sulltani,
Flamur i math për Vegjeli!*

Rron brenda kësaj vjershe gjithë historija Shqiptare,
dhe sidomos fryma Teftane e pardjeshme, sulmi Krutan
i djeshmë dhe Vrulli Vlonjat i sotmë dhe i përhershëmë.

IV.

Në shqyrtimin e veprës poetike të Fan S. Nolit
lipsen të përfstuhën jo vetëm vjershat origjinale po edhe
shqipëritet. Pa fjalë se këtu landa e parë, thema, është
e hojtur, po këtë lëndë shqipëronjësi e ka tretur në
flagën e gjeniut të vetë dyke na dhënë një ekvivalent
Shqipëtar të një vlere absolute. Të tillë janë shqipëritet
nga Poe: *Korbi* edhe *Annabel Lee*; nga Longfellow:
Skënderbeu, i shqipëruar në rithmin edhe masën e
këngëve t'ona popullore; disa fragmenta nga veprat e
Shakespeare-it edhe një pjesë e madhe e Rubajive të
Omar Khujam-it. Për të nënëvijuar vlerën dhe bukurinë
absolute të tekstit Shqip, kujtojmë disa vargje nga poemë
Skënderbeu:

Teksti Inglisht:

*But he cared not for Hospodars,
Nor for Baron or Voivode.*

Teksti Shqip:

*Po kujdes ay s'të ka
As për Bej as për Pasha.*

Këtu shqipëronjësi jo vetëm se ka dhënë dy vargje
të bukur, nga pikëpamja e stilit dhe e sulmit, po ka dhënë
ngjyrën krejt lokale, si pas intencionit të autorit. Gjithatë
ngjyrë lokale marrin edhe vargjet e tjera, si:

Teksti Inglisht:

*There came a Scribe of the King
Wearing his signet ring.*

Teksti Shqip:

*Nje Qatip na vjen i Mbretit
Me myhyrin e Dovletit.*

Teksti Inglisht:

*Then he bade them bind with chains
This man of books and brains.*

Teksti Shqip:

*Lidheni, tha, me litar,
Shkronjësin me kallamar!*

Gjithashtu krejt shqipe janë ato shprehje të bukura
që i gjen lëçitësi në tekst si: *flokë-bardhë, kokë-ngrirë,*
zemër-prerë, vdekje-grirë, etj. Pamvarësish në teksti i
origjinalit, ne i ndjejmë si t'onat edhe shumicën e
Rubajive, të veshura krejt në petkat e Shqipes. Kujtojmë
këtu disa prej tyre:

*Dhe kur tē shkosh, moj Dor-e-këmb-
argjende*

*Për tē gositisur miqtë n'ato vende
Ku pinim bashkë, dhe t'arrish ku rri
Mos psherëti, po zbras-më Kupën tēnde.*

Ose:

*Rrembyen mall memuriet a ar
Dhe i'Urtin plak e t'urët shkencëtar
E quajnë Gjaur, se s'beson pralla.
Se s'qas nû supet, si ata, samar.*

Tjatër:

*Ah, nesër Botën plot shamai' e lashë,
Nga qindra xhevairë njëz'i dhashë,
Pa folur kanë mbetur qindru fjalë,
Se nuk i merrte vesh kjo Bot'e trashë.*

Aqë i fuqishmë na është dukur dikur - dhe mbetet edhe - ky teksti Shqip i Bilbil Rushitit (i përkthyer "dervishçë" si i thonë dësa) në krahazim me dy përkëthime që kishim njojur Frangjish edhe Rumanisht, nga Shqipja. Dhe, lejohemi t'i sigurojmë lëcitësit, se vargjet që mburuan prej tyre nuk ishin asfare të shëmtuar dhe as më të ulëta nga tekstet e tjera të shtypura. Po, u-desh, në pragun e botimit të një pjese nga Rubajitë, të ndahemi nga teksti dhe nga dorëshkrimet t'ona. Gjithashtu, flasim me intuicion, pa njojur tekstet e originalit, i nëmërojmë si kriesa të gjuhës Shqipe atë Korbin e Edgar Poe's dhe ato fije vjersha të shqipëruara nga Shakespeare-i, të cilat lëcitësi i ka për tē gjetur në këtë përbledhje. Me gjithë se fort i vyer dhe i nevojshëm një thellim i shqipërimeve, pra një studim i krahauar i teksteve, ky i kalon mundësitet t'ona. Nënëvijojmë vetëm rëndësinë e tij, dyke u lënë barrën atyre që mundin dhe që zotërojnë gjuhën e originalitetit.

V.

Ç'munt tē themi, si përbledhje, mi verbin e Fan S. Nolit? Ja, këto fjalë: Fiziologjija specifike e vjershës Noliane është jo tuli, po muskla edhe eshtra. Nuk është kontemplativ, pasiv, pritës, po buçitës, sulmonjës, dërmnjës. Vargu i tij nuk është vizual, po auditiv. I drejtohet, pra, veshit, jo syrit. Dhe veshit i drejtohet jo me ondulacione lirike, me shushëllime të ëmbëla, po me një arsenal bubullimesh e vrungëllimesh si një grumbull baruthanash që martin zjarr e buçasën njëra më fort se tjatra ose si ajo zhurma e qerres tē Zotit Shëndelli nëpër fushat e qellit, kur fillon shtërgata. Një shtërgatë fjalësh Shqipëtare ose tē shqiptarizuara kjo e Nolit, ku buçet, si thamë më sipër, ashpërsia Teftane, Krutane, dhe Vlonjate, këto kulme heroike të racës Shqipëtare. Ushëtin brenda vjershës së Fan S. Nolit, ky Demiurg i Shqipes, si një vrulle rrëkesh që derdhen tatëpjetë, shpirti gjithmon i ri i kombit. I përngjan fort kjo vjersha e tija, në botën e tingujvë, muzikës Wagneriane, ku zotëron burija heroike dhe darabani i kushtimit, edhe jo telat e holla të serenadave melankolike. Vjersha e Nolit nuk ka ondulacionin e valëve në mezin e detit, po përplasjen e tyre anës, me zhurmë, gjithëmonë të përsëritur. Në botën e arkitekturës ajo nuk u përngjan pjesave të rumbulla, po çipeve të imprehta. Sepse Noli nuk gëdhend në mermer, po në krastë. Nuk limos me daltë, po pret me sëpatë dhe me çekan të rendë. Fan S. Noli sjell në letrat e Shqipes një stil individual, të tijnë, një vibration energjik, një verb violent me shprehje metaforike të forta, që rrökullisen njëra pas tjatës. E paravështrojmë se në gjuhën e tij kanë për tē shkrojtur, në të arthmen, shumë poetë dhe shkrimtarë Shqiptarë, që nga Izedin Jashar Kutruši, me

Poemin e tij Kosovar dhe gjë larg fort.

Dhe tani, në imbarim, pyetja që na rëndon në shpirt
është kjo: A do të kemi fatin të vazhdojmë dhe të
plotësojmë këtë veshtrim panoramik mi veprën poetike
të Fan S. Nolit? Në këto ngritjet edhe përmbyset e sotme
askush nuk mung t'a dijë. Dhe nëqoftësë na e refuzon
fati këtë hir, ata që vijnë pas nesh - se vijnë shumë dhe
të fortë - le t'a vijojnë.

Mitrush KUTELI

Qershor, 1943

Tiranë

*(Ribotuar nga libri "Mall e Brengë",
Tiranë 1943)*

I. **LIRIKA**

HYMNI I FLAMURIT

O Flamur gjak, o flamur shkabë,
O vënd e vatr' o nën' e babë,
Lagur me lot, djegur me flagë,
Flamur i kuq, flamur i zi.

Fortesë shkëmbi, tmerr tirani,
S'të trëmb Romani, as Veneciani,
As Sërp Dushani, as Turk Sultani
Flamur i madh për Vegjeli.

Flamur që lind, Shën Kostandinin,
Pajton Islamin' e Krishtërimin,
Çpall midis feve vllazërimin,
Flamur bujar për Njerëzi.

Me Skënderben' u-lavdërove
Dhe në furtun' i funtmi u-shove,
Me Malonë prapë lart vrapove,
Ylli pavdekur për Liri.

Sa shpesh pastaj për-dhë u-shtrive
Me zjarr e zi u-ndeze u-nxive,
Po çdo mizor me shpat' e grive,
O fushë-kuq, o shkabë-zi.

THOMSONI DHE KUÇEDRA

Te Ura, te Ura

Vraponi, o burra,

Me armë, me topa, me kordh' e me shpata,
Se dolli kuçedra e errët nga nata,
Se ngriti bajrakun e luer me gjak
Dhe sulet prej Shijakut në Durrës me vrap

Kuçedr' e Turqisë

Hyren' e urisë,

E rrahir nga Greku, nga Serbi e Bullgari
Do gjak të thëthijë dhe vjen te Shqiptari,
Si gjarpër zvarniset, i sillet përqark,
Me dinin në gojë, me helmin në bark.

Kuçedrën e vrarë

E hasi më parë

Thomsoni në Vlorë, kur vinte prej detit
Me katërqint krahë, lubi' e Dovletit;
E zuri për gryke, e shtriu përdhe
Nga thonjt'i rrëmbecu të mjerin Atdhe.

Pastaj për së dyti

Në Durrës e mbyti

Dhe kokën ia shtypi me top nga kalaja,
Kur hodhi Esadin nga Froni, nga maja,
Nga forca në pluhër, nga bregu në det,

Kuçedra e thyer,

Në turp e përlyer

Përmblidhet e kthehet nga toka në Durrës
Dhe ngrihet m'e fortë, në Gjol, afër Urës.
Shqiptar'i verbuar vërsulet në det,
Shkel Flamur dhe Nënë dhe villezër po vret.

"Dy herë të theva,

Të shtriva, të ndeva,

Po prapë u-njalle dhe prapë u-ngrite,
Prit-më, the, prit-më!" Dhe prap' iu-vërvite,
Dhe hovin e kuçedrës ia preve, po re,
Kalarës i huaj, që vdiqë për ne!

Nga Ura, nga Ura

Po ikni, o burra?

Ju ikni, po hij' e Kalarësit s'ikën!
Kuçedrës tërbuar ajo i fut frikën,
Se urën e ruan, se Urën e mpron
Stihia-Shqiponjë, me qip e me thonj.

Te ura, te Ura

Vajtoni, o burra,

Thomsonin e ngratë që ju vet' e vratë,
Që pas nuk i ratë, po vetëm e latë,
Kur shkonte kaluar të vdesë për ne,
Për ju, të mallkuar, që s'doni Atdhe.

JEPNI PËR NËNËN

Ç'thot' ajo e ve e gjorë,
- Mbretëreshë pa kurorë -
Faqe-çjerrur, lesh-lëshuar,
Shpirt e zëmër përvëluar;
Gjysm' e vdekur: "O Shqiptarë,
Nënës mos ia bëni varrë!"
Mbahu, Nëno, mos kij frikë
Se ke djemtë n'Amerikë.

Qan e lutet Nën' e mjerë,
Kërkon vatrén edhe nderë,
Do lirinë dhe atdhenë,
Si ç'e pat me Skënderbenë,
Bijt' e besës thërrret pranë.
Kur i thirri dhe s'i v'anë?
Mbahu, Nëno, mos kij frikë,
Se ke djemtë n'Amerikë.

Cilët jan' ata tiranë
Që të prent' e që të vranë
Që të therrë bij e bija,
Dhe t'u-nxi, t'u-mbyll shtëpija?
Dherthni plumba, o Shqiptarë,
Gjakn' e Nënës për të marrë,
Mbahu, Nëno, mos kij frikë,
Se ke djemtë n'Amerikë.
Cilët bij të trathëtuan

Dhc të doqnë dhe të shuan
Dhe të lan', o Shkab' e ngratë
Pa fole, pa zog, pa shpatë?
Këta qena, o shok'i mbytni,
Mbushni gjyke që t'i shtypni.
Mbahu, Nëno, mos kij frikë,
Se ke djemtë n'Amerikë.

Sa kërkon e sa të duhen?
Burrat nga detyra s'ndruhen!
Trim i mirë do të japë,
S'kursen jetën as paratë;
Hithni, hithni tok dollarë,
Të mos mbetemi të sharë.
Mbahu, Nëno, mos kij frikë,
Se ke djemtë n'Amerikë.

Do të ndihim pa kursyer
Për ty, Nëna jon'e vyer,
Që me drit' e nder të thuresh
Dhe me bijt' e tu të mburesh.
Cila Nënë lyp paranë?
Cilët bij me shpirt s'i dhanë?
Mbahu, Nëno, mos kij frikë,
Se ke djemtë n'Amerikë.

Armë dhe fishekë mblithni
Qesen edhe shpirtin hithni:
Për lirin' e vendit t'onë,
Sot-se nësër është vonë -
Jepni, Nënën të shpëtoni,
Komb e vatra të nderoni.
Mbahu, Nëno, mos kij frikë,
Se ke djemtë n'Amerikë.

MOISIU NË MAL

Ngjitet përpjetë Malit të shkretë
Krye-Profeti trimi me fletë,
Të bisedonjë me Perëndinë
Për Palestinë.

Arrin në majë lart i kapitur,
Qëndron me frikë, pret i trondituri,
Dhe Jehovaj i flet prej një reje
Me zë rrufeje:

"Ti dhe të tjerët pleq do të ngelni,
Tokën e Shenjtë kurrë s'e shkelni
Skllevë, bij-skllevësh, s'e meriton
Se liri s'doni!"

Krye Profetit dita i ngryset
Dhe shpirt-këputur përdhe përmbyset
Me lot në sy, me zemër të ngrirë
I lyp mëshirë.

Pse kaqë gjatë, Zot, m'arratise,
Pse më përplase, më përpëlise,
Pse shpresën dyzet vjet m'a yshqeve,
Dhe sot m'a preve?

"Nem Dhen' e Lirë! Zot ku m'a ke?
"Shiko, i tha, dhe ja ku e pe."
Së largu Zoti ia pasqyron,
Dhe e shikon.

Ja Nazareti, ja Bethlehemi,
Lum'i Jordanit, Jerusalemi,
Mal'i Sionës, Betsaidaja,
Dhe Golgothaja.

Sheh gasn'e pritmë për djalërinë
Dhe shkretëtirën për pleqërinë,
Atje sa bukur, këtu sa zi,
O Moisi.

Këtej ka dimrin, andej prënverën,
Kërkon Parasjen, vdes në Skëterrën;
Ajme, sa vrer, sa keq e sa zor,
Liberator!

Botuar për herë të parë në "Liria Kombëtare", 27.1.1930

MARSHI I KRISHTIT

Hosanna o çlironjës, Mesi, hosanna!
Shtroni udhën me lule, dafin' e hurma,
Brohoritni trumbeta, timpane, zurna,
(Thirr e zbras, o gurmas: Hosanna, hosanna!)

Kryetrim, që lëfton, triumfon për atdhe,
Shpëtimtar, kryemjek, kryeshenjt, kryefe,
Pasuri, dhe liri, dhe fuqi ti na dhe,
Lum e lum, Galile: Hosanna, hosanna!

O i bir i Davidit, i Miri Bari
Ti na prjn dhe na rrit në luath e vërrri
Ti na ruan, na mpron, dhe për ne bëhesh fli,
O Njeri-Perëndi: Hosanna, hosanna!

Përmbi Dhe, përmi Fron, përmi Qjell u-bekofsh,
Përmi djall dhc tiran, përmi Ferr mbretërofsh,
Me pean dhe temjan, dhe këmban'u- këndofsh,
Drit' e gas, rrofsh e qofsh: Hosanna, hosanna!

O i fort' o i urt' o i ëmbël Jesu,
Plot me bes' e me shpresë të biem mi gju,
T'adhurojmë më zëmër këtu e tëhu,
Gjithëkund e pa funt: Hosanna, hosanna!

Hosanna, o çlironjës, Mesi, hosanna!
Shtroni udhën me lule, dafin' e hurma,
Brohoritni trumbeta, timpane, zurna,
Thirr e zbras, o gurmas: Hosanna, hosanna!

KRISHTI ME KAMÇIKUN

Në kështjellë t'atdheut, në tempull të fesë
Janë shtruar sarafët pa shpirt e pa besë,
Tregëtojn' e gënjejnë, rrëmbejn' e sfrutojnë,
Thon' ashtu Iisraelin e mbrojn' e shpëtojnë.

Shtrembërojnë kanunet, i marrin në dorë,
Dhe shkëlqejnë në kish' e në fron me kurorë,
Vegjelia për ta bartërdisen dhe vriten
Dhe kështu parasitët gjakpirës po rriten.

Tradhetori dinak, hipokrit e kusar
Na u ngrit gjer në kulm, dhe u-bë krytar;
Nënë zgjedhën besnikët për vdekje lëngojnë,
Se mëkat dhe mallkim kryengritjen kujtojnë.

Çdo shenjt' ideal, çdo shtëpi Perëndie
Ishte bërë dyqan dhe pazar tregëtie:
Kush fitonte më tepër, ay ishte usta,
Dhe kush nu Akë plaçkitte ish krejt budalla.

Kur e pa këtë zi dhe këtë erësirë,
Krisht'i ëmbël u-ndes dhe u-bë i vështirë:
Me kamçik e me fshikull sarafët i dboj,
Dhe nga larot gjakpirës atdhen' e shpëtoj.

Dhe Shën Pjetri i gëzuar ahcre i tha:
“Ja tani e ke nisur tamam, or usta!
Me kërbaç e me shpatë mi ne mbretëro,
Dhe me forc' e pahir na çliro, na shpëto.”

“Je gabuar, o Krisht, që u ke predikuar,
Se të marrët, të shurdhërit s'kanë dëgjuar;
Ndreq kurrizin më parë, pastaj ndriço trurin.
Se shpirt-robi s'çlirohet askurrë pa drurin.”

Jesu Krishti s'dëgjoj, dhe s'e mori vesh mikun.
Dhe me lot i penduar e hodhi kamçikun,
Dhe i tha: “S'e ka fajin kurrizi, po truri,
Se lirin' e sjell drita e mëndjes, jo druri.”

“Merr-e prapë kamçikun, Shën Pjetri u-përgjeq,
Se përndryshe kjo punë na del mos më kcq.
Përketëdhel' u kurrizin dhe do t'të besojnë,
Vraj-i, shtypi, dhe shtrydhë, dhe do t'adhurojnë”.

Jesu Krishti s'dëgjoj, dhe s'e mori vesh mikun.
Dhe s'u-unj përséri që ta merrte kamçikun:
Dhe e kapnë kamçikun sarafët për fenë,
Dhe e shëmpnë çlironjësin, fen' e atdhenë.

SHËN PJETRI NË MANGALL

Fryn' e çfryn veriu,
Ngrin, mërdhin i ziu
Dhe mangallit i afrohet
Që të ngrohet.

Krishtin brënda e gjykojnë
Dhe pas ligjës e dënojnë,
E goditin dhe e shtyjnë,
E pështyjnë.

S'del askush që t'a shpëtonjë,
Roma do t'a kryqësojnë,
Triumfon Legaliteti
Dhe Laneti.

Kur e rrahin dhe e tallin
Pjetri ngulet mbi mangallin;
Kur e pa, u-koll këndezi
Nga qymezi.

Dhe një shërbëtore i tha:
- "Je dhe ti një nga ata!"
Po Shën Pjetri proteston,
E mohon.

Kuspull mi mangallin mblidhet,
Po djek dorën dhe përdridhet;
Se ç'këndon bandill këndezi
Nga qymezi:

"S'ka e s'ka si heroizma,
Edhe si idealizma,
Po kur dimër del behari
S'ka si zjarri."

- "Nga ata je!" - thot' ajo,
E mohon Shën Pjetri: - "Jo!
As e njoh, as e kam parë,
Moj e marrë!"

Kuspull mi mangallin mblidhet,
Po djek mjekrën dhe përdridhet;
Se ç'këndon bandill këndezi
Nga qymezi:

"Shkab' e shkëmb me poz e fjalë,
Se ç'na dolle shkrumb e galë,
Në je trim këtu tregoje,
Shko shpëtoje."

Thot' ajo: - "Je, mos gënje!"
Pjetri e mohon me be:
- "Jo, për Zotin, moj aman,
S'jam e s'jam."

Kuspull mi mangallin mblidhet,
Po djek gjuhën dhe përdridhet;
Se ç'këndon bardill këndezi
Nga qymezi:

- "Simon Pjetér, Bar Jona,
Kështu ndahet kjo dynja:
Kryqi andej, këtej buxhaku
Dhe allçaku".

Se ç'e dogje, se ç'e fike,
Gjel me gjemb' e këng' armike,
Dhe ndërgjegjen se ç'ia çpove,
Se ç'ia zgjove.

Se ç'vajton Shën Pjetri hidhur,
Lesh-lëshuar, duar-lidhur,
Tri her' e mohoj pa gdhirë,
Faqe-nxirë.

Botuar për herë të parë në "Liria Kombëtare", 21.2. 1930

MARSHI I BARABBAJT

Allalla, o rezil e katil, allalla,
Stroni udhën me hithr' e me shtok turfanda,
Gumëzhit, o zinxhir e kamçik, baterma,
Lehni, laro, kaba: Hosanna Barabba!

Tradhetor, ti na nxive, na le pa atdhe,
Ti na çthure, na çkule, na çduke çdo fe,
Varféri, poshtërsi, robëri ti na dhe,
Derbeder, ujk e derr: Hosanna, Barabba!

O stërnip i Kainit, tepdil si bari,
Ti na shtyp e na shtryth e ti gjakun na pi,
Ti na ther e na grin e për qejf na bën fli;
O kokuth e lubi: Hosanna, Barabba!

Në budrum, nëpër llom' e kufom' u-mallkofsh,
Në skëterrën, katran e tiran, u-harbofsh,
Me tam-tam e allarm' e me nëm' u-shurdhofsh,
Në zëndan mbretërofsh: Hosanna, Barabba!

O i çgryer, i zhyer, i vyer për hu,
Turp-e-ndot-kundërmモンjës të krusen mbi gju
Dallkaukët, kopukët e turmat pa tru,
Zémör-krund-e-gërtlu: Hosanna, Barabba!

Allalla, o rezil e katil, allalla,
Shtroni udhën me hithr' e me shtok turfanda,
Gumëzhit, o zinxhir e kamçik, batërma,
Lehni, laro, kaba: Hosanna, Barabba!

MARSHI I KRYQËSIMIT

Do të vrashim, Jesu, se të kemi Baba,
Do të varrim, Mesi, se të kemi Usta,
Se s'ke dashur as jet' as martes' as para:
Kryqësoje, Pilat, në Kalvar, Golgotha.

Dy kusarë të vegjël i zumë në lak.
Kryqësoji këta, se na vohnë fort pak,
Kryqësoje këtë, se s'na vodhi aspak:
Kryeqësoje, Pilat, në Kalvar, Golgotha.

Vrajeni, se përunj dhe përbys pasurinë,
Pasuron, dhe çliron, dhe forcon varférinë,
Se lëngatën shëron, se ndriçon verbérinë:
Kryqësoje, Pilat, në Kalvar, Golgotha.

Varreni, se me botën, me ne s'shëmbëllen,
Se na ndreq shtrëmbëritë, dhe kurrë s'na rren,
Se e do vegjelin' e tiran' e urren:
Kryeqësoje, Pilat, në Kalvar, Golgotha.

Vrajeni, se për vete s'kujdeset, s'lëfton,
Dhe të mjerët, të humburit nuk i sfruton,
Dhe për sherr, për villa-vrasje, përluftë s'punon:
Kryqësoje, Pilat, në Kalvar, Golgotha.

Varreni, posa s' do as tē vras' as tē vartë,
As tē bënje tē keqen as gjakun t'a marrë.
Dhe katilët me nam na i qan si tē marrë:
Kryqësoje, Pilat, në Kalvar, Golgotha.

Vrajeni kryengritësin e Shënjteruar
Si katil tē mallkuar, atë ka kerkuar,
Se kujtoj që pa armë na ka për tē zgjuar:
Kryqësoje, Pilat, në Kalvar, Golgotha.

KIRENARI

Ç'deshe ti, mor, në Kalvar,
O qyqar, o Kirenar!
Del me poçen për sehir,
Ndrit me Kryqin si martir.

Rent nëpër kallaballëk,
Se ç'po ngjan s'merr vesh as gëk,
Je i pir' e s'mban dot anë
Për çlironjës a tiranë.

Nëpër pluhër dhë shamatë
Turen burrat, çiren gratë
Turm' e ndezur, e tërbuar,
Krishtin për tē kryqësuar.

"Mir' e gjeti, the, sarafi,
Se ashtu is desh qylafi,
Se po çvishte vegjelinë
Me uzurën dhe vergjinë".

Po kur pe qe u-gënjeve,
Kryqësimin s'e pëlqeve.
Kirenar, se ç'the një fjalë:
"Mos e vrissni këtë djalë!"

Daleni, the, mor aman-ni,
Oratorin mos e ngani,
Si politikan flet n'erë.
Po s'e bën më tjatër herë!"

Fare bukur e fillove
Po më kot i këshillove,
Se katilët s'të sajdisnin,
Si pijanik të qesëndisnin.

Dhe kur pe këto havaze
Një dolli më verë zbraze
Për të mbytur mallëngjimin,
Për të shuar hidhërimin.

Po dollia të tronditi
Dhe mi krishtin të vërviti,
Të tre Kryqet i përfshive
Dhe për-dhe të gjith' i shtrive.

C'ngjau pasandaj s'kuptoве
Kryqin gjer sa e zapтоve
Dhe si Krisht u-kapardise
Dhe në djers' u-batërdise.

C'vete shtrëmbër në Kalvar
O qyqar, o Kirenar!
Se ç'permbysh, kamçikohesh,
Rrihesh, ngrihesh, çdehesh, zgjohesh.

Krishtin me habi pyet:
"Nga më krisi ky tërmët?
Pse pa faj po më mundojnë,
Kryqn' e huaj ç'm' a ngarkojnë?"

Krishti po të ngushëllon,
Dhe durim të këshillon:
"Mos kij dert, se u-bekove,
Me dolli lavdi fitove!

Mos kij dert, mor Kirenar,
Ta bën këngën një Shqiptar!"
"Po ku është Shqipëria?"
"Tek ndes vetë Perëndia!"

Bëj gjajret, mor Kirenar,
Drejt përpjetë në Kalvar!
Për paradën që bën ti
Çdo besnik të ka zili

Vjenë, 7 maj 1925

KRYQËSIMI

Po troket çekani
Po kërcet mejdani.
Dor' e kömb' i çpon,
Krishtin kryqëson.

Me tërbim goditin
Me gjëmim e ngjitim
Turma ulërin
Nëna blegërin.

Çdo peronë plagë
Përvëlon si flagë
Çurka gjak buron
Fryhet dhe pikon.

Kryqet ngulen, shtisen,
Tallen, qesëndisen;
Sipër Kryqe tre,
Tri Mari për-dhe.

KËNGA E SALEP-SULLTANIT

Një mexhlis të math na çeli
Pandeli Jano Vangjeli
Me Sulltan-llokum na veli
Si kofini pas të vjeli.

Fyt' i Floqit po pëlletet
Top i Krosit po kërcet;
Ç'është ky sheqer-kësмет?
Hallvaxhin e pamë mbret!

Dhé rakia vete-vjen
Xhafer Ypi na mbërthen
Dhe për lot na mallëngjen
Rreth konopit me legjen.

Koço Kotta, mjek hanxhari,
Nis një valle palikari,
Se me një ferman kusari
Sadrazem u-bë firari.

Dhe Feridi faqe ndron,
Die shante, sot lëvdon
Fryn bulçit' e trumbeton,
Që Katrani zbardhëllon.

Dhe sarhosh Iljas Vrioni
Dehet, siç e do zakoni,
Bërtet: "Rroftë Napoloni!
Kështu tha dhe Ksenofoni!"

Se ç'u-çporr xhumhurieti,
Se ç'u-rahatos miletë,
Se Sullatinin prap' e gjeti,
Se, që kur e humbi, s'fjeti!

Ç'ka sepse i vjetri qe
Madhështor sa një deve
Dhe ky s'bën as për meze!
Rroftë sa jep ylefe.

Se ç' na u-gëzua xhani,
Se ç' na preu Ramazani,
Se ç' na piu Itajlani,
Rroftë pra Salep-Sultani!

Vjenë, 15 Totor, 1928.

Botuar për herë të parë në "Liria Kombëtare", 28.II. 1928

SYRGJYN-VDEKUR

(Elegji për Luigj Gurakuqin)

Nëno moj, nbaj zi për vllanë,
Me tre plumba na i ranë,
Na e vran' e na e shanë,
Na i thanë tradhëtor.

Se të deshte dhe s'të deshnin,
Se të qante kur të qeshnin,
Se të veshte kur të çveshnin,
Nëno moj, të ra dëshmor.

Nëno moj, vajto, merr malin,
Larot t'a përbysnë djalin
Që me Ismail Qemalin
Ngriti flamur trimëror.

Nëno moj, m'a qaj në Vlorë
Ku të dha liri, kurorë,
Shpirt i bardhë si dëborë;
Ti s'i dhe as varr për hor.

Nëno moj, ç'është përpjekur
Gojë-mjalt' e zëmër-hekur,
Syrgjyn-gjall' e syrgjyn-vdekur,
Ky Vigan Liberator.

Berlin

Botuar për herë të parë në "Liria Kombëtare", 28.II. 1926

SHPELL' E DRAGOBISË

(Elegji pér Bajram Currin)

Kur tufani e çthuri fenë,
Kur tirani e krrusi atdhenë,
Mi një brek të Dragobisë
Priret Flamur' i lirisë.

Atje nisi, atje mbaroj,
Atje krisi, atje pushoj, -
Rufe-shkab' e Malësisë,
Në një shkëmb të Dragobisë.

Vendi dridhej, ay mbeti
Se s'tronditej nga tërrmeti. -
Dif dragonj i Dragobisë,
Trim tribun e Vegjelisë.

O Bajram, bajrak i gjallë,
More nam me gjak në ballë,
Te një shpell' e Dragobisë, -
Yll i rrall' i burriërisë.

Thon' u-shtri e thon' u-vra, -
Po ti s'vdiqe, or Baba,
As te shkëmb' i Dragobisë,
As te zëmr' e Djalërisë.

As je vrar' e as po vritesh
Legjendar Ante po rritesh. -
Dithiramb i Dragobisë,
Tmerr, panik i mizorisë.

Me Zjarr Shenjt u-ndrit kjo shpellë,
Gjer në qjell u-ngrit Kështjelle
Për çlirimn' e Shqipërisë
Katakombe i Dragobisë.

Berlin, 28 tetor 1926

Botuar pér herë të parë në "Liria Kombëtare", 28.II. 1926

Përsi i kafshëve e përmendjeve
Poza mi 'qet' e pës me dëz
Në kuzë, që nuk ka qëndruat

RENT, OR MARATHONOMAK!

Rent, or rent, rent e u thuaj
Se u-çthur ordi e huaj,
Se betejën e fituam
Dhe qytetin e shpëtuam!
Rent, or rent,
Rent, or Marathonomak!

Kap një degë prej dafine
Dhe vërvitesh ndaj Athine,
Nëpër fush' e brek mi brek
Këmba tokën as t'a prek,
Hip' e zbrit,
Petrit, Marathonomak!

Ke një plagë, po s'e the,
Djers' e gjak pikon për-dhe;
Do që ti të jesh i pari,
Për triumfin lajmëtari
Flamur-gjak,
Kuqo, Marathonomak!

T'u-tha gryka, po s'të pihet,
T'u-mpi këmba, po s'të rrihet,
Se miletë po të pret,
Ankthi zëmrat u a vret,
Vrer e tmerr,
Shpejt, or Marathonomak!

Kurrë kaq s'dogji djelli
Dhe si plumb s'rëndovi qjelli,
Kurri' aq ëmbel' e bukur s'ftoj
Hij' e lisit edhe kroj;
Tur-u tej,
Tutje, or Marathonomak!

Vapa mbyt e pluhri nxin
Ferra çjerr e guri grin
Afsha gjoksin përvëlon
Syrin avulli verbon;
Ur' e prush,
Furr'o, or Marathonomak!

Gryka si gjyryk të çfrym
Prej Vullkanit flag' e tym
Se ç'vengon e se ç'gulçon,
Zëmra brinjët t'i çkallmon
Me tokmak,
Mbahu, or Marathonomak!

Nëna, motra, nusja dalin,
Ngrechin krahët të të ndalin,
Mos, se s'janë veç Najada
Magjistica dhe Driada;
Lark, or lark,
Lark, or Marathonomak!

Hajde, ja Akropolia,
Ja qyteti e njerëzia
Që të pan' e që të çquan
Dhe fuqinë t'a rishtuan
Ha dhe pak,
Hajde, or Marathonomak!

Ja, arrive, ua the:

C'gas e ç'helm që kjo myzhde!

"E fituam!", brohorite

Dhe pér tok' u-pérpélite;

Vdiq, or vdiq!

Vdiqe, or Marathonomak!

Rent kudo, dyke bërtitur,

Népér shekuj faqe-ndritur,

Se i vogli shtrin viganin

Dhe i shtypuri tiranin,

Veç e tok,

Tok, or Marathonomak!

Prill, 1930

ANËS LUMENJVE

Arratisur, syrgjynosur,

Raskapitür dhe katosur

Po vajtonj pa funt, pa shpressë,

Anës Elbës, anës Spree-së.

Ku e lam' e ku na mbeti

Vaj-vatani e mjer-mileti

Anës detit i palarë,

Anës dritës i paparë,

Pranë sofrës i pangrënë,

Pranë dijes i panxënë,

Lakuriq dhe i dregosur,

Trup e shpirt i sakatosur?

Se ç'e shëmpnë derbederët,

Mercenarët dhe Bejlerët,

Se ç'e shtypnë jabanxhinjtë

Se ç'e shtrythnë fajdexhinjtë,

Se ç'e pren' e se ç'e vranë,

Ç'e shkretuan anembanë,

Nënë thundrën e përdhunës

Anës Vjosës, anës Bunës!

Çirem, digjem i vrerosur,

Sakatosur, çarmatosur,

As i gjall' as i varrosur,

Pres një shenj' e pres një dritë,
Pres më vjet' e pres me ditë,
Se ç'u tera, se ç'u-mplaka,
Se ç'u-çora, se ç'u-mplaka,
Lark prej vatrës dhe prej punës,
Anës Rinit, anës Tunës.

Çakërdisur, batërdisur,
Përpëlitem dhe zalisur,
Endërronj pa funt, pa shpresë
Anës Elbë-s, anës Spree-së.

Dhe një zë vëngon nga lumi,
Më buçet, më zgjon nga gjumi,
Se mileti po gatitet,
Se tirani lebetitet,
Se pëlcet, kërcet furtuna,
Fryhet Vjosa, derdhet Buna,
Skuqet Semani dhe Drini,
Dridhet Beu dhe zengjini,
Se pas vdekjes ndriti jetë,
Dhe kudo gjëmon trumbeta:
Ngrehuni dhe bjeruni,
Korini dhe shtypini,
Katundar' e punëtorë,
Që nga Shkodra gjer në Vlorë!

Ky ilaç e ky kushtrim
Më bën djal' e më bën trim,
Më jep forc' e më jep shpresë,
Anës Elbë-s, anës Spree-së.
Se pas dimrit vjen një verë
Që do kthehem i njëherë
Pranë vatrës, pranë punës,
Anës Vjosës, anës Bunës.

Arratisur, syrgjynosur,
Raskapitür e katosur
Brohorit me bes' e shpresë
Anës Elbë-s, anës Spree-së.

Hamburg, Maj, 1930.

Në dorëshkrim imban titullin "Mes lumenjve të Babylonës".

Dhe arriva dha...
Që t'kam qëndru...
Dhe përmend...
Dhe përmend...

PLAK, TOPALL DHE ASHIK

Dale, moj, se kam një fjalë,
Se më rrejdhin djersët valë;
Dale, moj, se s'jam më djalë
Dhe më s' ecënji dot.

Dale, moj, se më kapite,
Më këpüte, më sfilite,
Prit-e, moj, ashikun, prit-e
Që të vjen me not.

È arriva dhe ia thashë,
Asnjë gur pa tundur s' lashë,
Dhe më gjunjazi i rashë,
Ç'u-mundova kot.

Hapi gojën, dhe vajtova,
Qenkim plakur, e kuptova,
M'ardhi keq, po s'e mohova,
Syri m'u-përlot.

Dhe ngajeta u-mërzita,
Dhe ngalumi u-vërtita
Që të vdes, se u-korita
Dy-tri herë sot.

Po ti, Zot, më ngushëllove
Pas një tjatre më lëshove,
Dhe nga mbytja më shpëtove,
Lavdi paç, o Zot.

Dale, moj, se kam një fjalë,
Se më rrejdhin djersët valë;
Dale, moj, se jam i çalë
Dhe më s'ecënji dot.

Kjo poezi u botua për herë të parë në "Album" me pseudonimin Bajram Domosdova, ndërsa në dorëshkrimin ban titullin "Dale moj..." dhe datën 6 tetor 1927.

SOFOKLIU

Sofokliu ishte budalla,
Kur u-mplak, edhe Kupidi e la,
Tha: "Shpëtova nga një maskara!"
Goja, pra, iu-tha.

Sofokliu nuk e kishte mirë:
Plaku s'ka takat, po ka një dëshirë,
Gjalpë s'ka po ka një pus me hirrë,
Furrë dhe trazirë.

Kam Ferid Asllanin si shahit,
Tetëdhjet' e pesë vjeç ashik:
Amerika, Evropa u-çudit,
Nuse desh kur vdiq!

Flamurin që la e trashëgova,
Nat' e ditë çupa, gra kërkova,
Se ç' u-batërdisa, se ç' u-shova,
Se ç' u-përvëlova.

Kur të vdes, dhe kur të më mbuloni,
Çupa, gra, në vart mos më vajtoni.
Do t'ju dua prapë, siç më doni.
Dolla! Mos më zgjoni.

Edhe kjo poezi u botua për herë të parë në "Album" me pseudonimin Bajram Domosdova dhe titullin "Sofokliu dhe Ferid Asllani"... 10 shkurt 1946.

FRYN MOJ ERË...

- Ngaj po na vjen, n-oj erë e treptë?
Pse vërhellen me aq mallëngjim?
- Vij drejt nga malet e Shqipërisë,
për të përhapur zì e vajtim.
Frym, moj erë, moj erë e shkretë fryn,
drejt më zëmër, më zëmër time hyn.

- Nga ata male, moj erë trime,
ç'lajma të rea po na ke siell?
Pse je e mvrerë dhe e helmuar?
Qiellë me zì përsë na e mbiell?
Frym, moj erë, etj.

Pse e ke synë të trubulluar
e rent kaluar mi t'zeza re?
Pse të pikojnë lottë të zeza,
lottë të zeza posi rrëke?
Frym, moj erë, etj.

Syri m'u err nga ato që pashë
Ah! nukë mbahem, nuk duroj dot.
Pashë një gjëmë, gjëm të tmerruar,
rent ta haroj, po rentkam më kot.
Frym, moj erë, etj.

Atje tek losnja në fush' të Korçës,
dyke u hedhur lis më lis,
një qivur pashë me nj'çup' të virgjër,
ma vrau shpirtin ay filis.

Frym, moj erë, etj.

Tokat pushonin, prift nukë dukej,
e pakënduar na u varros;
mihnë dëborën, i bënë varrë,
shpirt nuk më mbeti, forca m'u sos.

Frym, moj erë, etj.

Atje mi varrë qante një grua,
një grua qyqe me mallëngjim;
burrën të qante më par'a çupën,
për kë të bënte më par' vajtim?

Frym, moj erë, etj.

Renda e ika e flytyrova,
po dhëmbjen time ku do ta fshet?
Çava oqeane, dete dhe male,
po vajtoj edhe sikundër sheh.

Frym, moj erë, etj.

- Moj er'e rreptë, erë malsore,
shpirti m'u ndes, zëmra më shkru;
sytë m'u errë si ty dhe mua,
mëndja në kokë më bubullin.

Frym, moj erë, etj.

Qëndro të lutem, të kam për t'dhënë
dhe un'i varfri një porosi:
një re të madhe dërgo të zgresë
e ta ngarkojmë me lott' e mi.

Frym, moj erë, etj.

E kur të kthchesh nga Shqipëria,
Atje në kopshtin, atje t'qëndrosh,
dhe lott' e mia si vesë qjelli
dalë nga dalë do t'i pikosh.
Qaj, moj erë, moj er'e shkretë qaj,
derthmi lottë atje mi varr'e saj.

Poezia u bota së pari në "Kombi", të Bostonit, më 25 janur
1907, me pseudonimin Ali Baba Qyteza

Të dhënat e së shumtë
e Shqipërisë nuk ka qen
Me mënyrën e Dostlindit
Për Myftuatin e Tiranës
Që vjen i përgjithshëm
Rashitët e tij
Të dhënat e së shumtë
Në këtë rast
Sëmundjet e tij
Kundërshtimet e tij

III

SHOIPËRIME

Aqet këtë qytet
Dhe u poqet këtë qytet
Në qytet përfshin më shumë se vërtet
Diverziteti i tij.

Fëmijët e tij

Të paktë e vënët, po që më shumë
Dëshirat e tij, që tashmë
Më shumë se vërtet, që tashmë
Që tashmë, që tashmë, që tashmë, që tashmë

Ajza e vërtet, që tashmë
Dëshirat e tij, që tashmë
Më shumë se vërtet, që tashmë
Që tashmë, që tashmë, që tashmë, që tashmë

Këndë e lla, që tashmë
Po dëshirat e tij, që tashmë
Që tashmë, që tashmë, që tashmë
Që tashmë, që tashmë, që tashmë, që tashmë

Fëmijët e tij

Më shumë se vërtet, që tashmë
Dëshirat e tij, që tashmë
Më shumë se vërtet, që tashmë
Që tashmë, që tashmë, që tashmë, që tashmë

Fëmijët e tij

Që tashmë, që tashmë, që tashmë, që tashmë
Dëshirat e tij, që tashmë
Më shumë se vërtet, që tashmë
Që tashmë, që tashmë, që tashmë, që tashmë

Fëmijët e tij

E ka që këtë qytet, që tashmë
Ajo ne këtë qytet, që tashmë
Diverziteti i tij

*Henry Wadsworth Longfellow
(1802-1882)*

SKËNDERBEU

Lëfton luftën dhe fiton
Mbreti Ladißlav gjëmon
Djek si Ferr, si vdekje pret
Ditën e Rushajevet,
Dhe nga fush' e kuqe gjak
Ikën, rent përpara tij
E Muratit ushtëri
Që shpëtoj e s'ra në lak.

Kur u-ngrys e kur u-err,
Skëndrebeu, nder, lavdi
I asqerit Osmanlli
Tok me Turqit krismën merr,
Si lëfton e si humbet
Ditën Rushajavet.

Mbet e vdekur prapa tij
E Murati ushtëri,
Kryerojtja udhën hap,
Praparojtja rent me vrap,
Dhe armiku gjakësor
Si me drapër grin e kor.

Po kujdes ay s'té ka
As pér Bej as pér Pasha,
Edhe natën tek' po shkon
Yjt' e fatit po shikon
Që i ndritin n'udhëtim;
Edhe kalit tij i ra,
Nënëqeshi edhe tha:
"Eshtë koha pér gjëzim".

Mez' i natës kur afroj,
Ikja e rreptë kur pushoj,
Një Qatip na vjen i Mbretit
Me myhyrin e Dovletit
Edhe tha me zëmërimi:
"Njoll' e parë t'u-vu sot .
N'emër, o Gjergj Kastriot!
Pse këshfu? Oh, mjerë ne!
Ushëtrinë pse e le
Therrur fushës pér vajtim?"

U-përgjeq Skënderi, që tha:
"Dergjen imbytur nëpër gjak.
Thembr' e kalit i ka prak,
Po këshfu e shkruar që
Nga i madhi Zot atje
Q'urdhëron çdo ushteri.
Dhe ku kemi ne fuqi
Kur ngre dorën kundër nesh
Dhe na gryren si rrëbesh?

"Lidheni, tha, me litar
Shkronjësin me kallamar"
Dhe Qatipi tha: "Po ç'saj
Paskam bërë që Pashaj

M'a bën mua këtë gjë?"
U-përgjeq Skënderi e tha:
"Faj s'ke bërë asnonjë,
Po që të mos na shpëtosh
Dhe të fshihesh e të shkosh,
Përandaj t'a bënë këtë."

Tani shkrua-më një shkrim
- Dhe pér fis e paç bekim! -
Me myhyrin e Dovletit
Pér Mytesarifn e Mbretit
Që mban Krujën, një qytet
Rreth me mur e me hendek,
Të m'a kthenjë gjën' e atit
N'emrin e Sullatin Muratit;
Se çdo urdhër që të japë
Kurrë nukç merret prapë.

Dhe Qatipi u-krrus prej tmerrit
Dhe këshfu i tha Skënderit:
"O Allah i math, i naltë,
Që të jemi hi e baltë!
Qysh t'i shkruanj këto shkrime
Kur e di që kokën time
Po m'a pret ay Dovlet?"

Shpejt ahore si një yll
Që këputet lark nga qjelli
Çpallet nga i arti myll
Një hanxhar me reze djelli
Dhe gjëmon Skënderi: "Shkruaj!"
Dhe Qatipi i tmerruar
Shkroj në dritën e drithmuar
Afër zjarrit, i dërmuar,

Flokë-bardhë, kokë-ngrirë,
Nga e stohta i mërdhire,
Zëmër-prerë, vdekje-grirë.

Dhe Skënderi prapë tha:
“Tani eja pas me mua
Se të mbetesh këtu s’dua
Do t’te kem si mik e vlla,
Gjithënë do t’te nderonj
Me kujdes do t’te rrëthonj
Sa të rrosh në këtë botë.”
U përgjeq Qatipi e thotë:
“Udha jonë këtu ndahet,
Shoqëria jonë s’mbahet.”

Pa mbaruar këtë fjalë
Një hanxhar i rëndë ra,

Kur s’ish afër asnjë tjatër
Dhe Qatipi po përbysjet
Si një gur që rrugullisët
Në ligjen të zi dhe shket
tatëpjatë dhe humbet;
Edhe rrëth në qetësi
Asnjë pipëtim s’u-ndi
Përveç kalit Skënderbeut
Që përpjek’ u-hodh prej dheut.

Pastaj sulet si shigjeta
Me tre qint pothua veta
Nëpër lum’ e pyll e garth
Përmi malet Argjendar;
Dhe me zemrën plot gjëzim
Kapërceu lumin Drin
Dhe u-gdhë e n’agullim

Pa kështjellën Ak-Hissar,
Krujën, ah atë qytet
Rreth me mur e me hendek,
Tek u-lint e tek u-rrit,-
Ylli mëngjezi mi të ndrit.

Dhe ahere trumbetarët
Brirëve t’argjëntë u bien
Edhe togje rrëth i mblidhen
Turqit bashkë me Shqiptarët
Që dëgjuan atë thirrje.
Dhe kremitoj me miqt’ e tij
Dhe u-ngrohnë me dolli.

Dhe u thotë: “Miqt’ e mi,
Shihni fati ç’na dërgon,
Perëndia ç’na bekon!
Mbret Murati urdhëron
Mall’i gjëri i tim-eti,
Vend’ i terë dhe qyteti
Të më jipen nga Dovleti.”

Dhe pastaj me saltanet,
Veshur me armët si një mbret,
Shkon kaluar në kështjellë
Edhe hyn nga port’ e gjerë
Dhe pashajt që urdhëron
Përmi Kruj’ i dorëzon
Urdhërin e Murat Mbretit
Me myhyrin e Dovletit.
Dhe Pashaj, si heshti, tha:
“Lavdi pastë Perëndia,
Ja ku hiqem nga fuqia.
Merr-e vendin dhe qytetin;
Kush lëfton doi me kësметin?”

Nga kështjella shpejt ka rënë
Flamuri me gjysmë-hënë
Edhe populli shikon
Që në vënt të tij valon
Flamur' i Skënderit n'erë
Shkab'e zezë me dy kërë.

Dhe një thirrje lart-u-ngrit,
Se çdo zëmër e çdo shpirt
U-mërzit nga Turku i lik,
Q'e kish bërë atë Krujë
Zi, murtajë dhe rrëmuqë.
Ay zë me gas me bujë
Q'oshëtin nga brek në brek
Éshtë: "Rrofsh, o Skanderbeg!"

Ja kështu Skënderi trim
Mori Krujën me rrëmbim;
Edhe lajma u-përhap
Si një flagë, si një zjarr
Q'i fryn era në behar
Dhe qytetet afër larg,
Thotë Ben Isa Ben Miri
Në Qitap, të tij fakiri
"Binin m'atë lehtësi
Që zë burri veshn'e tij".

Eskili
(525-456 p.e.r.)

Nga PROMETHEU I MBËRTHYER

Hefesti me Përdhunën dhe Pahirin
e sjellin Prometheun
të lidhur mi një shkëmp të Kafkasit.

Përdhuna:

Arrimë tek m'i larkmi çip i dheut,
Në malet e pashkelur ië Skithisë.
Ti, pra, Hefest, pas urdhrit atëror
Këtë keqbërës e mbërthe mi shkëmbin,
Dhe lidh-ë me vargonj të paçkëputur,
Se lulen tënde, zjarrin kryemjeshtër,
Ta vodhi, ua fali njerësve.
Kështu mëkatin e tmerruar jan.
Mëson t'i unjet mbretërisë Jovit,
Dhe dorë heq nga helm'i njeridashjes.

Hefesti:

Përdhunë dhe Pahir, pér ju të dy
Ndalim pér porrosin' e jovid s'ka.
Po mua s'më bën zëmra të mbërthenj
Gjirinë perëndi mi këtë shkëmp.
Mjerisht jam i shtrënguar ta zbatonj,
Se nuk e shkel dot urdhrin atëror,

O bir i mënçur i Themidës drejtë
Pa dashur un'aspak, dhe ty pa dashur
Do tē mbërthenj mi këtë shkëmp tē shkretë,
Ku s'ke pér tē dëgjuar zë njeriu,
Ku do tē piqesh nën diellin,
Ku ditën do tē preç notin' e natës,
Dhe natën vapën brymë-shkrirëse,
Se do tē përvëlonjë gjithnjë
Mundimi i së keqes së tanishme,
Se çlirimtari yt s'ka lindur edhe.
Këto t'i solli vepr' e njeridashjes,
Si perëndi, s'iu trëmbe perëndisë,
Dhe njerëzit pa mas' i pasurove.
Këtu, pra, u-dënove tē qendrosh
Tendosur, gju pa cpur, dhe pa fjetur,
Këtu do tē vajtosh me lot më kot,
Se Jovi s'ka mëshir' e nukë zbutet:
Çdo mbret i ri në krye ësht' i ashpër.

William Shakespeare

Nga "HAMLETI".

Thuaj yjtë s'janë zjarr

Thuaj yjtë s'janë zjarr,
Thuaj dielli u shua,
Thuajjeta është varr,
Po mos thuaj që s'të dua.

Të rrosh a të mos rrosh

Të rrosh a të mos rrosh - kjo është çështja:
M'e lartë është vallë tē durosh.
Hobe, shëgjeta fati tē tërbuar
A tē përballsh një det tē turbull helmesh.
Me arm' e funt t'u japsh. Të vdeç - tē flesh
Jo më! - dhe me një gjumë tē mbarosh
Çdo zëmër - dhëmbje, mijëra tronditje,
Që trupi prej natyrës trashëgon,
Ja një qëllim që duhet dëshëruar
Me gjithë shpirt. Të vdeç - tē flesh; tē flesh?
E nofta t'ëndërrosh! ah, këtu ngec;
Se ç'ëndrra shohim n'atë gjumë vdekje,

Pasi na shkundet kjo pështjellj' e mortime,
 Kjo frikë na qëndron; ja arësyja
 Që aq e zgjat një jetë me mjerime;
 Se kush duron përbuzjen dhe kamçikn e botës,
 Zullumn' e shtypesit, përdhunën e krenarit.
 Lëngim' e dashuris' së papërfillur,
 Vonimn' e ligjës, gojë-çthurjen e zyrtarit,
 Dhe shkclmet, që çdo vlerë zëmër-gjëre
 Nga të pavlershmit merr, kur munt t'alanjë
 Hesapin fare me një copë thikë?
 Kush vallë barra mban e kush dërsin,
 Rënkon nënë një jetë të mërzitur,
 Po vetëm tmerr'i saj diç pas vdekjes -
 Vëndit të pazbuluar, nga s'na kthehet
 Kurr' udhëtari - na trullos vullnetin,
 Dhe vuajmë të ligat që po kemi
 Se sa të hidhemi n'ato që s'dimë.
 Kështu na bën ndërgjegja gjith' frikaçë;
 Kështu dhe ngjyr' e gjall' e rezollutës
 Sëmuret, verdhet nga hij' e mejtimit,
 Dhe pllane të mëdha e rëndësore
 Ndalen, përqajnë rrjetëshen, dhe humbasin
 Emrin e vepërimit. Hesht tani!
 E bukura Ofeli! Ëngjëll, në lutjet
 Mëkatet m'i kujto të gjitha.

Si t'a njoh trimin që më do vërtet

Si t'a njoh trimin që më do vërtet
 Nga ndonjë tjatër trim?
 Nga syri dhe nga zëmra që m'i flet
 Zemrës e syrit t'im
 Më vdiq, o shoqe, dhe më la,

M'a vunë në qivur;
 Mi varrin bar tani më ka,
 Mi kokën ka një gur.
 Të bardhë si dëbor' e kishin savanin
 Me lule të stolisur,
 I vogël e i math me lot e qanin
 Me zemër të zalisur.

II.

Shën Valentinin nesër po kremltoj
 Dhe ngrihem në mëngjes
 Dhe, vajzës, nga dritarja po i shkonj,
 Se nukë mund të pres.
 U-ngrit ay ahere dhe u-vesh
 Dhe derën po ia çel,
 Në dhomën brenda vajza hyn e qesh,
 Po vajzë jashtë s'del.

III.

Për Zotin Krisht, për Zonjën Shën Mëri,
 Ajme, sa turp, sa keq!
 E bën, kur e gjen rasjen djal'i ri,
 Dhe vajza shkon në dreq.
 I thot ajo: "Më bërë be, pa shtrirë,
 Që do t'më merrnje grual!"
 I thot ay: "Vërtet, po s'je e mirë,
 Kur fle për turp me mua!"

Kuri shari, kuri kisha dashuri

Kur isha i ri, kur kisha dashuri,
ah dashuri,
E kisha zëmrën plot me lumtëri,
Me nuse e me dasm' e me kurorë;
ah kurorë,
Isha si dash me brir' e me këmborë.

Po e pabesa pleqëri më theu,
ah më theu,
Me pançën e me thonjtë më mbëtheu,
Më çthuri, m'arratisti në kurbete,
ah kurbete,
Në male, në shkëmbinj, në pronj e dete.

Një bel, një bel, një kazm' e një lopatë,
ah lopatë,
Dhe një savan i gjërë dhe i gjatë;
Një grop' e thellë dhe përsipër baltë,
ah moj baltë,
Kështu e do kjo mysafir' e naltë.

Nga "OTHELLO"

E varfëra rrëzë një mani po rri

E varfëra rrëzë një mani po rri,
Qaj, shelk, o shelk i zi;
Me kokën mi gjunjë, me duar në gji,
Qaj, shelk, o shelk i zi;
dhe lumi buçiste me këng' e me vaj,
Qaj, shelk, o shelk, o qaj.
Dhe shkrinin shkëmbinjtë nga lotët e saj,
Qaj shelk, o shelk, o qaj.

Miguel de Cervantes Saavedra

Nga "DON KISHOTI"

Këtu prehet një bari

Këtu prehet një bari
Që na shriu dashuri
Mi një e gërsirë mali,
Dhe kështu na humbi djali,

Zemra se ç'iu përvëluar
Q'e përbuzi ajo grua
Dhe u-døq ky trim i ri
Nga e flakta dashuri.

Ah! dashuria s'paska hiç mëshirë

Ah! Dashuria s'paska hiç mëshirë,
Se më ka shëmbur e më ka përpire,
Se unë asnjë të keqe, s'i kam bërë
Që m'a ka prerë shpresën me gërshëre.

Po, perëndi, kur qënka dashuria,
Ahëre siç na thotë Dituria,
S'e merr kalemi që të na mundonjë
Dhe shpirt e zëmër të na përvëlojnë.
S'them dot se fajin m'a ke ti, moj Fillë;
Nga e mjalta jote s'del një helm i tillë,
Dhe kurre s'them se vjen nga Perëndia.

Ahëre vdes, kështu e zgjidh problemin,
Se ndryshe s'kam se si t'ia gjenj melhemin
Lëngatës që s'i dihet katandia!

Male, pyje plot me fletë

Male, pyje plot me fletë
Të mbëdhenj e të përpjetë,
Pa pushoni e më dëgjoni,
Ejani më ngushëlloni
Për hatanë, pér belanë,
Pér qederin, pér sevdanë,
Që më çthuri anembanë.
Këtu qan trim Don Kishoti te dëllinja
Pér largimin nga Dylqinja
E Tobozës.

Te ky vënt më solli fati,
Fat' i zi e taksirati,
Se si unë s'ka ashik,
Dhe si unë s'ka bësnik,
Dhe kështu më mori djalli,
Më svarnis pér kapistall
Pra, nga halli e nga malli
Këtu qan trim Don Kishoti te dëllinja

Pér largimin nga Dylqinja
E Tobozës.
Dyke ndjekur aventyra,
Tek ky mal i shkretë hyra,
Po më ndjek nga pas sevdaja
Më qëllon, më ndjek murtaja
Me shigjetën e helmuar
Dhe jam djejur, përvëluar,
Dhe kështu i dëshperuar
Këtu qan trim Don Kishoti te dëllinja
Pér largimin nga Dylqinja
E Tobozës.

Jam marinar i dashurisë

Jam marinar i dashurisë
Dhe në furtun' e n'ocean
Plevas pa shpres' e midis zisë
Se nukë shoh asnjë liman.

Si prijes kam një yll té zjartë
Që pér së largu e shikonj,
Nga Palinuri ndrit më kjartë,
Atë pasonj, atë vazhdonj.

Po nukë di se ku më shpie,
Sillem vërdall' aty-këtu
Dhe herë hipënj, herë bie
Si pas tallazit kuturu.

Kur yllin m'a mbulojnë retë
Dhe nëpér qjell s'e shoh gjékunt,
Humbas torruan në det té shkretë
Dhe frika zëmrën m'a lëkunt

O yll i ndriçim, kij mëshirë,
Dil prap' e ndrit-më, se té pres;
Në perëndofsh një her' e mirë,
Ahore di-e se po vdes.

Këtu dergjet Don Kishoti

Këtu dergjet Don Kishoti:
Isha i fort' e ish i zoti,
Botën prapa desh t'a kthente
Dhe me ushtën t'a mbërhente.

Këtu brënda fle Dylqinja:
Se ç'këndonte si mëllinja!
Ish e kolme, rumbullake,
Faqe-kuqe, pupulake.

Këtu dergjet Sanço Pança:
Si ay s'ka parë Mança!
E kish barkun sa një kosh,
E kish kokën fare bosh.

Këtu dergjet Rosinanti:
Ishte më interesanti
Nga çdo kalë që kulloti
Barin që ka bërë Zoti.

Omar Khajam

Nga "RUBAIRAT"

* * *

A di përsce këndezi po këndon
Me-natë dhe nga gjumi po të zgjon?
Që shkoj një ditë po të lajmëron,
Dhe ti, çkujdesur, fle dhe éndërron.

Zgjoh-u! Mëngjezi me shigjet' e grisi
Perden e Natës, Yjt i arratisi.
Dhe Dielli gjahtar me reze kapi
Çdo majë mali e pallati e lisi.

Qesh Trëndafili e thotë: "Lulëzonj
Dhe botës bukurinë po ia shtonj:
Pastaj e hap kuletën e mëndafstë
Dhe përmi kopsht thesarin po e shtronj."

Mbi lule po pikojnë vesë retë,
Dhe me një zë qjellor Bilbil' i shkretë:
Ah, Verë! Verë! Verë! Trëndafilit
I lyp të skuqë faqezën e zbetë.

O ti, mi Dhe m'e zgjedhura Selvi,
M'e shtrenjtë je se shpirti e syt e mi:
Gjë më të çmuar se sa Jeta s'ka;
M'e çmuar një qint herë më je ti!

Zefire fryre, syri im të pa;
Nga gjoksi zëmra m'iku dhe më la
Dhe dyke flutuar pas të ra:
Banesën sot në gjoksin t'ënt e ka.

Kush në Gërmadhën të ka prurë, kush?
Kush t'a ka çfaqur natën nurë, kush?
Kush të ka fryrë të më ndezësh furre
Nga Dashuria të sëmurë, kush?

Rënkoj e psherëtinj, se s'të kam pranë,
M'u-çuar zëmra, vojtjet mënt s'më lanë,
Askujt s'ia qanj dot hallin, djall'o punë:
Vrer, mijalt'e flagë-vet' e qjell-hapsanc

Nga hidhërim'i ndarjes jam përpirë,
Sa e sa herë zëmra m'çshë grirë:
Ty natën të kujtonj e psherëtinj,
Nga malli digjem, si qiri kam shkrirë...

Natën kur flinja, më tha shpirti: "Pi!
Në gjumë dhe në Varr s'ka lumëri;
Ngreh-u! Sa rrон, zbraz kupa dhe puth Çupa!
Ke shekuj që të flesh në qetësi."

Në ëndër, kur Agimi zbardhëllonte,
Një zë që nga Taverna po gjëmonte:
"Çohuni, djem, o Verë sillnani,
Se fati na e thau lëngun sonte."

Dhe posa në Tavernën këndojoj gjeli,
Besnikët jashtë thirrë: "Portat çel-i!"
E shkurtër është Jeta, ja, u-mplakmë
Dhe mabetmë si kofini pas të vjeli.

U bëra prapë djal'i ri: Sill Verë!
Kërceni me flag' e lumëri: Sill Verë!
S'ka gjë në qoft e hidhur, më Saki,
Si jeta ime në Persi: Sill Verë!

Sakinjtë derdhin Ver' e vala Rrushi,
Në zëmrat shuajn' afsb' e avull prushi:
Lavdi, o Zot, se dhe këtë ballsam
Që na shëroj e me shëndet na mbushi.

Ah, mbushni Kupat! Zëmra na thërrret,
Se koha nëpër këmbë po na shket:
E djeshmja vdiq, e nesërmja s'na gjen;
Ç'mërziti kur e sotmja ka lezet.

Më mirë bukë-that' e rrobë-çyjer
Me ujë rro, i lirë, poçe-thyer,
Se sa tiran prej sklevësh gjak përlyer
A skllaf në zgjedhë shtypëse mbërthyer.

Mos e përdor për shtypje sqojtësine,
Mbjaj veten, zotëro me fre mërinë:
Në daç të shkosh në paqen e përfuntme,
Goditje prit, po mos godit njerinë.

Çudi, që parësi' e titulluar,
Nga skllavëria balbur, shtazëruar,
Kur shohin një të varfër po të lirë,
E quajn' a të marr' a të mallkuar.

Rrëmbyen mall, memuriet e ar,
Dhe t'Urtin plak e t'urët shkëncëtar
E quajnë Gjaur, se s'mbeson prallat,
Se s'qas mi supet, si ata, samar.

Të kisha ah! fuqi prej Perëndie,
I jipnja shkemin kësaj Gjithësie
Dhe krenja Botë tjatër ku të kishte
Çdo plotësim dëshire dhe lirie.

Ah, nesër Botën plot shamat' e lashë,
Nga qindra xhevahire njëz' e dhashë:
Pa folur kanë mbetur qindra fjalë,
Se nuk i merrte vesh kjo Bot' e trashë.

Ah, nesër ndahem nga e murmja Botë
Ku shkova një Jetesë krejt të kottë:
Asnjë s'kam zgjidhur prej Enigmave;
Dyshimi më ka shtypur nënë rrotë.

Për vdekjen s'dridhem as derth fare lot;
M'e mirë gjë në botë s'gjendet dot:
Trëmben nga Jeta që i Madhi Zot
Më kot m'a dha-e un ia kthenj më kot.

Pas Vdekjes nukë dua veç pushim;
Se sy e shpirt m'u-tretnë me vajtim;
Më keq se sa kam vojtur në Ferr s'ka;
S'dua Parajsë! S'dua veç harrim!

Miq, shpresa, Qjell e Tok' e Djaj më lanë;
Zi brënda, lart e posht' e anëmbanë;
Veç Verës s'më ka mbetur tjatër mik.
Dhe dua dhe në Varrin t'a kem pranë.

Me Verë, kur t'ap shpirt, kungomëni,
Me Verë Lamëni, bekomëni,
Me fletë Pjergulle pështillmëni,
Në kopsht me Këng' e Rrush mbulomëni.

Me Pemë, Trëndafij e me Hardhi
Varrin stolismani, qëndismani:
Rreth meje buzë-qeshur shtrihuni
Spërkatmëni me Ver' e pihuni!

Që Varri im me Ver' e Rrush të shirë
Tym, afshë të lëshonjë si një Tirë
Sa kur të shkonjë Musliman' i mirë
Si në pusi të dehet i papirë.

Dhe kur të shkosh, moj Dor'e-këmb'-argjënde
Për të gostitur miqtë n'ato vënde,
Ku pinim bashkë, e l'arrish ku rri,
Mos psherëti! - po zbraz-më Kupën t'ende.

Dhe kur të shuhen nën Dhe të zi
Dhe kur të bëhem prapë Balt' e Hi,
Mbrumëni Poçe, mbushmëni Dolli -
Dhe shihni po s'u-ngjalla përsëri!

Edgar Allan Poe
(1809-1849)

KORBI

Një mes-nate të bezdisur
Tek këndonja i salizur
Disa pralla dhe magjira
Të një shkence të harruar,
Tek dermitnjë i kapitur
Befas vjen një e trokitur,
Me ngadale e goditur
Përmi derë t'odës sime.
“Dikush është, thashë, jashtë
Që troket mi derën time -
Vetëm kjo, dhe asgjë më.

Ah, e mbanj nér mënt fort mirë,
Ishte dimr' i stoht' i ngrirë,
Dhe n'oxhakun shkrump të nxirë
Urët shuheshin në hi.
Desha të gëdhihej dita,
Se më kot nga librat prita
Të më ngushëllonte drita
Për të lumurën Lenorë,
Vajz' e rrallë dhe rezore,
Q'i thon' Engjëjtë Lenorë,
Përmi dhe pa emër më.

Era frynte që përjashta
Rrihte perdet e mëndafshta
Dhe më ngjethte dhe me derhte
Tmerre që s'i ndjeva kurrë.
Dhe tani që të pushonte
Zëmr' e injerë që lëftonte,
Goja po më bëlbëconte:
“Dikush do të hynjë brënda;
Nonjë vizitor i vonët
Që kërkon të hynjë brënda.
Kjo do jet' e asgjë më”.

Mblodha veten menjëherë
Edhe frikë më pa ndjerë:
“Zot, i them, a Zonjë, fajin
Ndjemani, ju lutem shumë,
Se për Zotin po dremitnja,
Aq' e hollë ish trokitja
Aq' e lehtë ish goditja
Përmi derë t'odës sime
Sa mezi ma zuri veshi.”
Dhe e hapa derën sheshit,
Errësir' e asgjë më.

Syrin thellë n'errësirë
Shumë ndënja në drithtirë,
Endërra dyke shikuar
Që njeri s'ka ëndërruar;
Mirpo nat' e errët heshtte
Edhe tjatër gjë s'më theshte
Veç një emër që më deshte
Pëshpëritur si “Lenorë!”
Këtë un' e pëshpërita,
Dikush m'u përgjegj: “Lenorë”.
Vetëm kjo, dhe asgjë më.

N'odë prapç më tē kthyer
 Shpirti ndezur, zemra thyer
 Përsëri vjen një trokitje
 Pak m'e fortë se më parë.
 "Pa dyshim, pa fjalë, thashë
 Dikush është aty jashtë,
 Duhet vajtur, duhet parë
 Që tē zgjidhet ky mister.
 Hesht, mos zëmër e zhuritur,
 Që ta zgjidh këtë mister,
 Era ësht' e asgjë më."

Hap ahene xhamen time
 Kur me shumë fërfellime
 Brënda hyn një Korb i mvrenjtur
 Madhështor i kohës vjetër.
 As u-fal as përshëndoshi,
 As bën tjetër punë boshë
 Po si zot më shkon trimoshi
 Dhe qëndron mi derën time -
 Ngjitet mi një bust Pallade
 Mun mi derë t'odës sime -
 Ngjitet, rri, dhe s'bën gjë më.

Më zu gazi, më shkoj tmerri
 M'atë Korb tē zi si Ferri,
 Që po mbahej aq'i rëndë
 Aq, i lartë, dhe i thom:
 "Ndonëse je perçe-prerë
 S'ka dyshim, je trim i ndjerë,
 Korb i mvrenjtur, i vrerosur,
 Arratisur zall më za;
 Thua-m' emrin tënt me nam
 Anës detit Plutonian!"
 Thotë Korbi: Kurrë më."

U'çudita fort, pa masë
 Kur dëgjova Korb tē flasë
 Ndonëse ajo përgjigje
 S'kishte as kuptim as lidhje,
 As asnjë s'munt tē më thotë
 Që nonjë njeri në botë
 Gjer tani ka parë shpëndë
 Mun mi derë t'odës tij,
 Shpënd' a shtazë mi statujë
 Mun mi derë t'odës tij,
 T'emëruar "Kurrë më."

Mirëpo Korbi rrinte shtruar
 Përmi bustin e latuar
 Dhe thosh vetëm atë fjalë
 Që nga shpirti plot me flagë.
 Asnjë pëndë më s;lëviste
 Asgjë tjetër s'murmuriste,
 Edhe zëmra më thërriste:
 "Miqt'e tjerë ikn' e shkuani;
 Nesër edhe ky do t'ikë
 Si dhe shpresat që m'u-shuan."
 Thotë Korbi: "Kurrë më".

I habitur nga përgjigja
 Që më dha kur nuk e prisnja,
 "Pa dyshim, kjo fjalë, thashë,
 Ësht' e vetëma që di
 Q'e mësonjë nga i-zot' i mjerë,
 Derë-mbyllur, derë-sterë,
 Që e ndoqi, e dogji zia,
 Dhe e shoqti lebetia.
 Gjer sa vaj'i shpresës tij
 S'qe veç dëshpërim i ri
 Edhe kurrë, kurrë më."

Edhe Korbi më mbëtheu
Dhe në gas buzën ma ktheu.
Shpejt, pra, një kolltuk rotova
Edhe derës iu-afrova;
Dhe i ndënjur ëndërronja
Dhe me mëndjenj po kërkonja
Që të gjenja, të zbulonja
ç'desh të theshte Korb'i zi,
Korb i mvrenjtur, i vrerosur
Arratisur zall më zall
Me dy fjalët "Kurrë më".

Këtë desha të çkoqitnja
Po as fjalë nuk i flisnja
Korbit që me sy prej prushi
Zëmrën si me zjarr ma mbushi;
Kështu rrinja i trallisur
Pshtetur kryet mi përkresën
Kadifeje të qëndisur
Që e ndritte llamba sipër,
Mi të cilën ah, e mjera
Do mos pshtetet më përsipër
Do mos pshtetet kurrë më.

Era u-dent përmi qilimet
Me temjan nga Serafimet
Që u tingëllin zilet
Posht' e lart në dysheme.
"Ja, me engjë, mor i mjerë,
Të çoj Zotù këtë herë
Prëhje, prëhje dhe nepenthë
Të harrosh Lenorën lart.
Pi, gjëlltit këtë nepenthë
Dhe harro Lenorën lart!"
Thotë Korbi: "Kurrë më."

"Profet, thashë, nëmë-rëndë,
Po profet, qofshë djall a shpëndë!
Qoftë, se të çoj shtrënsata
A Shejtan'i Ferrit Zi,
Të përhumbur, të patrëmbur
Tek ky vëndë i shkret' i dhëmbur
Tek ky burg me tmerr i shëmbur,
Thuaj-më, vërtet, të lus:
A ka në Gallad balldam?
Thuaj, thuaj-më, të lus!
Thotë Korbi: "Kurrë më".

"Profet, thashë, nëmë-rëndë,
Po profet, qofshë djall a shpëndë!
Për një Qjell dhe Perëndi
Që po lusm un' e ti,
Thuaj-m'i zëmrës që mban zi
A do shoh n'Eden të shenjtë.
Q'i thon' Engjëjtë Lenorë?"
Thotë Korbi: "Kurrë më."

"Mbyll-e gojën, dreq a shpëndë!
Ngrihem dhe thérres më këmbë,
Çporru prapë mun në djali,
Në skëterrë dhe në zall!
Pëndë mos me shkunt të zezë
Të më rrej' e të më ndezë;
Mos ler shenjë të gënjeshtës
Që më the, po shko prej derës!
Nxir-m'a qipin tënt prej zëmrës
Thyej qafën jashtë derës!"
Thotë Korbi: "Kurrë më."

Edhe Korb'i zi i humbur
Qëndron edhe i patundur
Mi tē zbetin bust Pallade
Mun mi derë t'odës sime.
Edhe sytë i shkëndritin
Si prej djajsh që ëndërritin
Edhe llamba që ndrit sipër
Ja hedh hien përmi dhe;
Shpirti im nga ajo hie
Që valon atje mi dhe
Do mos ngrihet - kurrë më.

ANNABEL LEE

Ka shumë e shumë vjet
Në një vënt afër në det,
Ish një vajzë që mundtni t'a njihni tani
Nënë emërin Annabel Lee;
Dhe kjo vajzë më donte edhe tjatër s'kërkonte
Veç t'a deshnja sikundër më desh.

Isha i vogël dhe ish e vogël në vjet
N'atë vënt afër në det;
Po duheshim më tepër se me dashuri,
Unë dhe im-Annabel Lee;
Me një dashuri që dhe Engjëjtë lart në laydi
Që të dyve na kishin zili.

Andaj, tani e shumë vjet,
tek ky vënt afër në det,
Fryri veriu nga ret' e m'a ngriu
Të bukurën Annabel Lee;
Edhe motrat e saj ëngjëllesa
M'a rrëmbyen, m'a mbylli në varr se e desha,
Dhe këshfu më la shëndet
Nga ky vënt afër në det.

Engjëjtë që s'kishin sa ne dashuri
Që të dyjve na mbanin mëri.
Po-përandaj, siç e dini vërtet

Te ky vënt afër në det
Fryri veriu një nat' e m'a ngriu
E m'a vrou tim- Annabel Lee.

Dashuria që kishim ish m'e fortë se çdo dashuri
S'e ka patur as plak as i ri,
As i marr' as i urtë njeri,
Dhe as Engjëjt e qillit në erë,
As demonët përposh në skëterrë;
Shpirtin l'im s'munt t'a shqitit nga shpirti
I së bukurës Annabel Lee.

Se te hëna që ndrit, syri im çndërrit
Për të bukurën Annabel Lee;
Dhe çdo yll që shkëlqen syt'e ëmbël nrëfen
Të së bukurës Annabel Lee;
Nat' e ditë e shoh, edhe zemrën m'a ngroh
Shoq' e dashura ime, e mjera jetime,
Përmë varrin ku deti buçet.
I rri pranë mi varrin në det.

Charles Baudelaire
(1821-1867)

ASAJ QË SHKOJ

Rreth meje rruga ulërin edhe buçet,
E gjat' e hollë, sterrë, kujë madhështore,
Një grua shkoj me një fustan të zi për direm
Q' e kolovitte posht' e lart me saltanet.

Si ëngjëj si statuj' e gjallë vetëtin.
Si e shastisur dhe i çakërdisur unë,
Nga syri saj si qjell që mbrun furtunë
Thëthinja mjaltë që magjeps, dëfrim që grin.

Ja shprepi dhe u err. Moj flutur e farosur,
Që me vështrimin tënt më bëre flag' e fumë,
S'të shoh më vallë veç në jetën e pasosur?

Ah, gjetkë, tutje, tepër vonë, nofta kurë,
Se unë s'di ku ike, ti ku shkonj s'e di,
Të desha, mos, e dinje, vetë moj, dhe ti.

Paul Verlaine
(1844-1896)

JETIMI

Kam ardhur unë, një jetim,
Zengjin prej syve dhe belave
Në njerëzit e kasabave;
S'ma varrnë, s'më gjetnë qesqin.

Kur isha trim njëzetvjeçar,
U-përvëlova nga sevdatë,
I desha që të gjitha gratë;
S'më deshnë, më lanjtë beqar.

Pa patur mbret, vatan, a gjak,
pa patur zëmër që të vrisnja,
Në luftë vajta që të vdisnja,
Po vdekja s'më përfilli aspak.

Kam ardhur von' a tepër shpejtë?
Ç'po bënj në botën un'i mjeri?
O shokë, më myti qederi;
Për mua lutuni, o të drejtë.

Fedor Ivanoviç Tjutceff
(1803-1873)

DASHURIA E FUNTME

Ah, kur na ngrysetjeta, se ç'na tret
M'e nxehëtë dhe m'e mprehtë dashuria!
Shkëndrit, mos dritë, që na le shëndet,
Mos dasm' e funtme, shkrepëti nga zia.

Nga Lindja gjysm'e qjellit na u-err
Pak vetëm na shkëlqen nga Perëndimi;
Qëndro, qëndro, mos mbrëmë plot me
vrer,

Vazhdo, vazhdo, or diell ngazëllimi.

Nga dimr' i ftohtë gjaku na u-mpi,
Po zëmra ndrit me lul'e me lëndinë;
Mos nus'e funtme, helm e lumëri,
Ç'ma dogje, çma gëzove pleqërinë!

BIOGRAFIA E PESHKOP NOLIT

Hirësia e Tij Peshkop Fan Sifilian Noli lindi më 6 Janar, 1882, në Qytezë, turqisht Ibrik-Tepe, një fshat Shqiptar të Thrakës afër Adriatikojës. Më 1906 ardhë në Amerikë, dhe u-vendos në Boston, Mass. Shtudioj në Harvard University, New England Conservatory of Music, dhe në Boston University, ku mori doktoratën e filosofisë në histori.

Përfaqësoj Shqipërinë pranë Lidhjes së Kombeve në vitet 1920-1924. U-bë Ministër i Punëve të Jashtme më 1921, dhe më 1924 Kryeministër i Shqipërisë.

U-dorëzua prift më 1908 në New York prej Kryepeshkopit Rus Imzot Platon, dhe Peshkop Mitropolit i Dursit në Korçë më 1923 prej Hirësive të Tyre, Imzot Kristoforit, Mitropolitit të Beratit, tani Kryepeshkopit të Shqipërisë, edhe Imzot Hierotheut, Mitropolit të Korçës, tani të ritiruar në Malin e Shenjtë. Vepëron që më 1930 dhe këtë si kryetar i Peshkopatës Shqiptare të Amerikës.

Vepërimin kombëtar në Amerikë, Peshkop Noli e Nisi më 1906 si ndihmës redaktor i gazetës Kombi, të drejtuar prej atdhetarit të shkëlqyer, Z. Sotir Peci nga Dardha. Pas largimit të këti prej Amerikës, themeloi gazeten "Dielli", të cilën e drënj që më 15 të Shkurtit gjer më 15 të Tetorit 1909; pastaj, për herën e dytë, që më 7 të Tetorit 1910, gjer më 7 të Korrikut 1911; pastaj për herën

trejtë, që më 21 të Dhjetorit, 1915, gjer më 6 të Korrikut 1916.

Ka qenë një prej themeltarëve të Vatrës më 1912, dhe shërbeu si kryetar i saj në dy periudha, më 1915-1916 dhe më 1917-1918. Nënë kryesinë e tij Federata Vatra arriu kulmin e lulëzimit me nja pesë mijë anëtarë, dhe lojti një roll historik për shpëtimin e Shqipërisë. Për këtoshërbimë u-zgjoth në Dhjetor të motit 1942 kryetar honorar i vatrës, dhe e mban këtë ofiq gjér më sot.

Parathënie

Qëllimi kryesor i këtij *albumi-albumi II*, i Nolit, është që të mos lemë vjerdha e funtme të mësuesit dhe udhëheqësit tonë të mykën dhe të kalben në shtyllat e Diellit. Domethënë këtë veprë e quajta për detyrë që të bënj për Nolin atë që bëra për Faik Konitzën, kur mbloida brënda dy kapakësh dorëshkrimet e tij, nënë titullin: *Albania: the rock garden of southeas - tern Europe*. Titulli është yni jo i Konitzës, me një ndryshim të vogël: Konitza s'ma la mua porosi atë detyrë, po rasti më detyroj që të mos i le shkrimet e tij të çmuara të mykëshin dhe të harrohëshin.

Në lidhje me Nolin çështja ndryshon. Kur u ndashë me të, më 18 të Nëntorit, 1964, Noli më tha: "Tani mos hajde të më shikosh, se më 20 të këtij muaji (dy ditë më vonë) shkonj të dimeronj në Florida, po të lutem shumë mblidhi të gjitha vjershat që janë botuar në Diellin këto vjetet e fundit që t'i botojmë në një copë broshurë kur të kthehem nga Florida në Prill, po sido që të ngjasë, përkujdesu për to."

E kuptova mirë se ku e kish fjalën Noli. Si ay dhe unë realizuam faktin e hidhur që Nolit po i nëmëroheshin ditët.

Kështu pra, kur mora mandatën e Nolit, më 13 të Marsit, 1965, ndonëse isha i sëmurë, më ardhë shpesh ndërmënt fjalët e tij të funtme dhe fillova të preqatit vjershat për botim.

Në Korrik, 1965, shkova për një çlodhje të shkurtër në Wells, Maine, një vënt shumë i bukur për çlodhje, i cili bashkon detin me boriga madhështore.

Përveç bukurisë natyrale, Wells, Maine, ka një tjetër arësyё tërheqëse për mua, se këtu pranë, në U. S. Route 1, ndodhet tregëtia e Zotit dhe Zonjës Sokrat Totoni,

Maine Diner, të cilët s'kanë munguar kurrë të na presin me gëzim dhe të na gostitin kurdoherë që na shpie udha atje, kështu pra, për neve Wells, Maine, është bërë një shtëpi e dytë.

Po ka dhe një tjetër arësy: pranë këtij vendi të bekuar, ndodhet komuniteti Shqiptar Biddeford-Saco, Maine, më këto dy kolloni, të cilat i ndan vetëm një lumë, u-themelua Dega e Vatrës Nr. 7, më 16 të Qershorit, 1912, me Ilo Andonë arkëtar. Zyrtarët e tjerë s'rrojnë më, po të gjithë ky shkronjës i par njojur personalisht.

Posa mësuan shokët e Degës në fjalë që ndodheshim atje pranë, shpejtuan të na bëjnë një vizitë mirëpritëse. Të parët ishin veteranët Niço Vangjel Grabocka dhe Ilo Andoni. Pas tyre mbrinë dhe dy të tjerë, Ismail Mevlani dhe Xhelio Sherif panariti.

Pus një dy ditësh na bënë një vizitë të dytë Ismail Mevlani dhe Xhelio Panariti. Vizitorët këtë herë na gjetnë në Maine Diner që përmendet më sipër.

Si në vizitën e parë ashtu dhe këtë herë, bisedimi u-zhvillua rreth ndodhjes tonë fetare dhe kombëtare pas vdekjes të Nolit. Në këtë bisedim bënин pjesë vetëm hosti bujar, Sokrat Totoni, Ismail Mevlani dhe Xhelio Sherif Panariti.

Në këtë bisedë informale u-hap çështja e disa vjershave që la pas Noli, botuar në *Diellin* që më 1961 dhe gjer më 1963, të cilat natyrisht, s'janë botuar në *Abumin* e Nolit, dhe po të mos mblidhen brënda dy kapakësh, do të mykeni në shtyllat e *Diellit*.

Të tre shokët e pranishmë më nxitën që të mos lemë xhevairët e Nolit të kalben, dhe më shiguruan se do të ndihmojnë materialisht në shpenzimet e shtypit. Zotimin që më dhanë e mbajtën një-qint-për qint, ndonëse shumica e shokëve të këtyre të dy komuniteteve janë poihuaj të retiruar dhe trojmë me pensionin që marrin nga qeveria.

Mjerishi ndihma e tyre s'ish mjaft për të përballuar shpenzimet e shtypit, kështu pra, posa u-kthyesh në Bos-

ton i bëra një vizitë një admirondës të Nolit, të cilin s'e kisha parë që kur vdiq Noli. Personi në fjalë preferon të mbetet anonim, po pati fisnikërinë të më dorovitë me një shumë bujarë. Po as kjo shumë nuk mbaronte dot punë.

Pas pak ditësh takova kryetarin e Vatrës, Zotin Anthony Athanas, dhe pasi i shpiegova çështjen, pa një pa dy, më dorëzoj plotësimin e shpenzimeve të shtypit.

Të gjithë emrat e kontributorëve do të botohen në një fletë të veçantë në funt të librës, po ndihmat, meqenëse janë për një vepër memoriale, nuk do të shënohen, se është kundër etikës të publikohen ndihma të tilla. Po i shigurojmë të gjithë kontributorët se shuma totale mezi mbulon shpenzimet e shtypit dhe auktori nuk pasurohet, Ndërkohë i falënderojmë të gjithë ndihmëtarët për sakrificat e tyre, të cilat bënë të mundur botimin e librës.

* * *

Gjatë jetës tij letrare Noli ka pas përdorur të paktën një pesë pseudonime. Pseudonimin e parë, *Theofan Mavromati*, më duket e përdori kur përktheu Gërqisht librin e Sami Frashërit: *Shqipëria q'ka qenë, q'ëshi dhe ç'do të bëhet*. Këtë vepër Noli e përktheu në Egjipt dhe u-botua me shpenzimet e Thanas Tashkos dhe Jani Vruhos. Pseudonimet e tjera që ka përdorur Noli nga koha në kohë janë: *Ali Baba Qyteza*, *Rushit Bilbil Gramshi*, *Bajram Domosdova* dhe *Namil Namazi* që figuron në vjershat që botohen në këtë vëllim.

Në konkluzje vlen të shtohet që Noli është i vetëm Shqiptar n'Amerikë që figuron në *Webster's Biographical Dictionary*

Boston

Gusht 1, 1966

Qerim Panariti

Victor Hugo
(1802-1885)

(*Les Contemplations, Libër i Katërtë, XIV*)

LULE MI VARR

Mesnatë, nesër kur të zbardhet fush' e shkretë,
Do nisem. Se më pret, e di që jam vonuar;
Do shkonj nga pylli dhe mali i përpjetë;
Më tepër s'munt të pres lark teje i mërguar,

Do të bares me sytë në kujtimet kridhur
Pa par' asgjë, pa ndjer' asnjë shamatë;
I vetëm, i panjohur, krusur, duar-lidhur,
Vrerosur, edhe dita do më bëhet natë.

S'kam për të par' as perëndimin ar' e zjarr
As lundrat me pëlhura tutje në luginë,
Dhe kur t'arrinj, më gjunjë do të vë mi varr
Një tufë lule besilok e trëndëlinë.

"Dielli", 11 janar 1961

Vjershëtori e shkrujt më 1847, katër vjet passi e bija 18 vjeçar umbyt tok me të shoqin 26 vjeçar në lumin Siene në një aksident. E përktheu nga Frëngjishtja Namik Namazi.

(*Les Contemplations, Libër i Katërtë, XV*)

VAJTIM PËR BIJËN

Tani që shkova nga Parisi i vështirë.
Mermer, tavane, truall, mjegull nukë shoh,
Tani jam nënë lisa, nënë deg' i shtrirë,
Dhe bukuri' e qjellin mëndjen po m'a ngroh.-

Tani nga zia që më çthuri si gërmadhë
I zbet' i gjallë dal.
Më hyn në zemër paqja e natyrës madhe
Dhe qetësi më fal.

Tani me valat det'i gjërë më gostit,
Më prek i qeti, madhështor horizon;
Tani të thellat të vërteta po nxonit,
Dhe lulet e lëndinës syri m'i gjzon.

Tani, o Perëndi, po gjenj fuqinë sterre
Të shoh me syt' e zes
Të shkretin gur nënë të cilin vajz' e mjerë
Fle gjumin pa mëngjes.

Nga pamjet perëndore mëndja m'u ndriçua,
Nga fushat, pyjet, brigjet, lumi i kulluar,
Shoh vogëlinë time dhe çudit' e tua,
Mbledh mëndjen, e di që je i math i pambaruar.

Ja ku të vinj, o Atë që besonj, o Zot,
Të sjell përunjësish.
Zëmrën që m'a ke mbushur me lavdi, dhe sot
M'a theve plotësisht.
Ja ku të vinj, o Zot, dhe proklamonj që je
I mir' i ëmbël' i shëmpshur, Perëndi i jetës,
I vetëm që di se ç'bën edhe përsë.
Njeriu është kallm i shëmbur i kënetës.

Të thom që varri, kur të vdekurit mbulon,
Portën e qjellit hap,
Që jeta jonë tatëpjetë kur imbaron
Përjetë nis me vrapi.

Je i pasosur, absollut, dhe i vërtetë
Ti vetëm, At i lartë e pranonj mi gju;
Pranonj që është mirë, është e drejtë
Që zemra m'u-përgjak, se Zoti e deshi ashtu.

Më s'kundërshtonj për asnjë gjë që po më ther,
Se ashtu deshe Ti;
Shpirti nga zi në zi, edhe nga vrer në vrer
Shkon në përfjetësi.

S'po shohim curr' asgjë përveçse nga një anë,
Tjatr'anë mbytet në mister e në furtunë;
njeriu vuan nën zgjedh' e s'e di shkaknë,
Çdo gjë i fluturon, asgjë s'i hyn në punë.

O Zot, përherë na rrethon me shkretinë
Me pranga dhe me fre;
S'ke dashur kurr të na japësh shigurinë
Dhe gazin përmi dhe.

Sa shohim një të mirë, fati na e tret,
S'na dhë asgjë në jetën rot' edhe rodhan
Që të qëndronjë dhe të thomi, mor aman;
Kam një shtëpi, një arë, dhe një dashuri.
Çdo gjë e shohim për një çast të kufizuar
Dhemplakemi pa shtek;
Kështu na qenka, ashtu ka për të vazhduar.
Pranonj edhe s'e prek.

Kjo bote, o Zot, kjo harmoni e pandryshuar
Përbëhet me vajtime edhe me kretime;
Bërrthama jemi në tufan të pambaruar,
Të mirët hipin, dhe të liqtë zhyten në mundime.

E di, o Zot, ke punë shumë, dhe s'ke nge
Për ne të bëhesh vrer;
Për nënën vdekj' e foshnjës djek si një rufe,
Po ty s'të bën qeder.

E di që pema bie kur i fryn një erë,
Zogut i bie pënda, lulja shkunt aromën;
Kriesa është rot' e madhe si poterë,
Dhe sillët rrötull dule shtypur udhës llomën.

Se ditët, muajt, valat, sytë që vajtojnë
Kalojnë pa pushim,
Se bari do të mbinjë, foshnjat do të shkojnë,
E di, o Zoti im.

Në qjellin tënd përsipër reve të vështira,
Në kaltësirën e patundur madhështohre
Po mbrun e po gatit kush e di ç'mirësira
Ku hyn si pjes' e duhur dhëmbja njerëzore.

Për pllanet e panumërt që po përmban
Të duhet pa dyshim
Të mbytën bukurit' e dheut në tufan,
Në zi, dhe në mjerim.
Kanunet që hartojnë fatin njerëzor
Nukë tronditet, nukë zbuten asnë herë,
Se s'munt, o Zot, t'a çthuresh rendin botëror
I shtyrë nga mëshira për njerin' e mjerë.

O Zot i math, të lutem, hith një sy mi mua,
Shëroj-e shpirtin tim;
I ëmbël, i përunjur posa foshnj' e grua
Të vinj me adhurim.

Kujto, o Zot, që kam punuar që në krye,
Që jam përpjekur, jam mejtuar, kam lëftuar,
Natyrën kam shpieguar plot më arësyje,
çdo gjë me kthjellësinë tënde kam ndriçuar.

Detyrën time e mbarova besërisht
Përballa zëmërim,
Pra nuk prisnja me të drejt' e natyrsisht
Nga ty ketë çpërblim.

Nga e parëshikonja kurrrë që dhe ti
Me krahun tënt të më goditnje munt mi kokë
Dhe mua që kam patur rrallë prokopi
Të m'a varrosnjë bijën kaqë shpejt në tokë.

Më zëmrën të plagosur kaqë rënd' u drodha
Të nëma me furi
Si foshnjë, edhe kundër tejë nofta hodha
Një gur në det të zi.

Kujto, o Zot, njeriu po dyshon kur vuani,
Se syri që po qan verbohet n'errësirë
Se në budrum ku ështi nukë çquan,
S'të sheh, e s'të përfill, e s'të kërkon mëshirë.
Njeriu që fundoset thellë në greminë
Në pis' e në katran,
Nuk ështi e mundur të gëzonjë qetësinë
Të yjve në mejdan.

Sot unë, që si nënë isha i dobësuar,
Në këmbë të përunjem nënë q... jell të lirë,
Nga hidhërim' i egër ndenj që jam ndriçuar
Dyke shikuar gjithësinë ca më mirë.

O Zot, e di që jam i çmëndur pa kufi
Kur murmurit e shanj;
Pra hesht, s'mallkonj, e s'akuzonj, po nem liri
Të çirem e të qanj.

Më ler më kuj' e lot, me vaj e vrer të ngrysem
Posa njerin' e bëre pér litar e hu;
Mi këtë gur të ftotë ler-më të përmbyssem
Dhe të pyes: Moj bijë, a e di që jam këtu?

Më ler t'iunjëm mbrëmane mi vart t'i flas
Kur bota rrëth pushon,
Se nofta çngjelli në qjell, kur të bërgtas,
Çel sytë, e më dëgjon.

Ajme, për kohën e kaluar kam zili;
Tani asgjë në botë ngushëllim s'më sjell;
Përherë atë çast me sy e shoh tani
Kur hapi krahët edhe fluturoj në qjell.

Nuk e haronjë gjer sa të vdes çastin e zi;
Ç'të qava, o çast, më kot!
Bërtita: o Zot, qëparthi e kisha, dhe tani
S'e kam! dhe qanj me lot.
Zot, mos u-zëmëro që sillem si i egër;
Kjo plagë pikon gjak, dhe s'ka asnje shërim;
Sa vete helmi ashpërohet ca më tepër;
Jam i përunjur, po s'kam më aspak durim.

Zot, mos u-zëmëro, faqen m'a dhe për hall,
Syrin m'a dhe për lot.
Po forcë dhe takat s'më dhe që t'i përball
Zullumet bot e bot.

Shiko, fëmijët po na duhen pa dyshim,
O Zot; se fati na përmbyti n'errësirë,
Na thuri me andralla, helm e hidhërim,
Po një mëngjes na zbarth me hir edhe mëshirë.

Një foshtë lint, një kok' e dashur dhe e shtrenjtë,
E vogël, gas përhap,
E bukur sa beson që dor' e saj e shtrenjtë
Portën e qjellit hap.

E pashë lulen që Imzot në kopsht më mbollë,
U-rrit me hir, me ëmbëlsi, dhe kthjellësi,
E dashura nga nata në mëngjes na solli,
Na ndriti si një diell zëmër dhe shtëpi.

Vazhdoj me vjete si i vetëmi gjëzim
Që munda t'ëndërronj;
Tani, o Zot i madh, kupton se ç'hidhërim
Po ndjenj që s'e shikonj.

"Dielli", Maj 31, 1961

Shkruar më 1844 dhe titulluar në original "A Villequier", ku ishte varrosur tok me të shoqin e bija e vjershëtorit pas aksidentit në lumin Siene. E përktheu nga Frëngjishtja Namik Namazi.

WATERLOO

(I dedikohet Faik Konitzes)

Waterloo, Waterloo, Waterloo, fushë e shuar,
Si valë që po zjen në shtëmbën e rashuar.
Në këto pyje, brigje, dhe lugina horre
Vërviti vdekja veteran' edhe tabore:
Nga njëra an' Evropa, Franca tej m'at'anë;
Në gjak u-mbytnë! Frénql' u-nxinë si katranë;
Vitorja e kapitur i braktisi, ajme!
Moj Waterloo, po qanj çirem pa çare:
Këta ushtarë të bëtejës funtmë qenë
Të dorës së parë: Kishin mundur tërë dhenë;
Përmbysnë njëzët mbretër; shkuan Alpet, Rinin;
Dhe shpirtet me trumbeta trunxhi u-blegérin.

Po ngrysej; ndeshja isht' e zjarri, burrat koren;
Kishte ofensivën, ment fitoj vitoren:
Mbërthyer përmi pyllin Wellington' e mbante;
Me një dylbi në dorë herë sehit bënte
Bëtejën munt në mest, pérleshjen e vështirë,
Përfytjen njerëzore, bush edhe trazirë,
Dhe besas tha me gaz. "Grouchy-u!" Ish Blucher-i,
U-hoth m'at'anë shpresa, ndeshja frymë ndroj,
Pérleshja u-përhap, si flagë përvëloj,
Se batareja Inglize trumbat na i dërmonte,
Bajraku yn' i cjerur n'erën drithëronte,
Dhe fushat ku të vrarët përpëlteshin

U-bë një furre ku metalet shkriheshin,
Greminë ku taboret posa mure grirë
Po binin shtrohëshin posa kallnj t'arrirë
Me daullxhijnt' e gjat' e kokëpendë
Të shëmbur, të plagosur thell' e rëndë.
Tmerr, kasapan' e lebeti. Ushtari e dinte
Që nëpër duartë bëteja vaj-shkrinte.

Prapa një bregu Gard' e Mbretit ishte mbledhur;
Tani e funtmja shpresë Garda kishte mbetur.
Dhe kumandari tha: "Tani lëshoni Gardën!"
Lloçnar' e grenadinj të mbathur me ovjalën,
Dragonj që Roma i merte për legionarë,
Topçinj që zbrazin vetëtima, dhe shqytarë
Me një helm që ndrit a me kalpak të zi
Trimat q' u-çuan në Friedland, në Rivoli,
Kuptuan që tani do vdisnin në mejdan,
I thirrnë disit, të përpjetë në tufan,
Si më një goj' e më një klithmë: "Roftë Mbreti!"
Pastaj ngadalë, të patrëmbur nga tërmeti,
Të qetë dhe me gas përballin topin hasmë
Dhe me muzikën Gard' e Mbretit hyn në dasmë.

Ajme! Napoleoni Gardës iu-drejtua
Dhe i shikoj që duallnë në shesh radhuar
Në zjarr edhe në squfur që çfryn top' i lik,
Njërin pas tjetrit pa taboret shkemp çelnik
Të treten si qiri në flag' edhe në furre.
Me armë shkuan kryelartë dhe stoikë,
Asnjë s'u-praps. Ju lumtë, trima heroikë!
Pasardhësit, s'kuxonin t'ecnin përmi ta,
E panë Gardën që u-çduk. Ahere pra,
Dishfata llahtarisor dhe fytyreshur,
E zbet' e ngriti zërin besas dëshpëruar,

Na i çkallmoj taboret, na i handakosi,
Bajraket na i çori dhë na i reckosi.
Si një fandazmë tymi dhe si një stih
U-ngrit, u-tur, mi çdo tabor dhe ushtëri;
Dishfata del përpara çdo ushtari e bataloni,
Bërtet krahë-përdredhur: "Ikni dhe shpëtoni!"
Pra, iknë të shpëtonin. Turp e tmerr! Të gjithë
Bërtisnin; nëpër fushë të xhindosur krisnë
Sikur një erë fryri edhe i marrosi,
Nër araba dhe në kazane i krusullosi,
U-futnë nëpër thekrat, pronjtë, dhe bataket,
I hothnë teshat teç, dyfjet dhe bajraket,
Përpara shpatës së dashmanit Prusian,
Dhe veteranët qajn' e ikin mor arman.
Si kasht' e djegur, humbni n'erë në një çast
Ky nam i tërë botës, ky Asqer i Math.

Kjo fushë ku po ëndërrojmë sot, ajme,
Pa q'ikn ata që bënë botën t'ikte dje!
Kaluan vjete, dhe kjo tok' e neveritur,
kjo Waterloo, ky shesh i mbytur i dremitur,
Ky Ferr ku Fati mbledhi tok sa hic-katrancë
Na dridhet se i pa kur ikn' ata viganë.

"Dielli", 7 Gusht, 1963

E përktheu nga Frëngjishtja Namik Namazi.

SULLTANI DHE KABINETI

Shokë, sot karo panair,
Shokë, bëmëni sehir;
Sillni kupar e gjostisë,
Sillni shishet e rakisë!

Kup' e parë, jam Aga,
Kup' e dytë, jan Pasha,
Kup' e tretë, çpall ferman,
Ngjesh një paill e jam Sulttan.

Jam Ali Qopeku i Parë,
Qen si unë s'kini parë;
Pra, kur leh, dorëtrokitni,
Zbrasni topa e brohoritni.

Jam imami e jam dovleti,
Padishahu e Muhameti,
Jam Xhenemi e jam Xheneti,
Kijameti e selameti.

Jam xhamia e jam namazi,
Jam zinxhiri e jam kafazi,
Jam budrumi e jam zullumi,
Kush ngre kokën e mërr lumi.
Kush do ligj' e republikë
Me status e me llogjikë
E ka pisk, dhe ngordh si horr
Në konop si tradhëtor.

Jua nisa historinë
Dhe ju solla prokopinë;
Lë pas meje dinasti
Për vazhdim dhe për lavdi.

Nukë pata parë-ardhës,
Po ju le një bir pasardhës
Gjurmën time të pasonjë
Dhe vatanin t'a sundonjë.

Shkruaj ti, O Bash-Qatip,
Shkruaj mpreht' e me tertip,
Lidh-i llomatit e mia
Shkrep-i nesër tek xhamia.

Ty, Abdull-Jezid Sersem,
Ty të bëra Sadrazem;
Nxir nga burgu çdo rezil,
Çdo kusar dhe çdo katil.

Ty, Abdul-Xhahil Nefer,
Ty të bëra Serasqer;
Bjer-u armiqve, shuaj-i,
Thyej-i dhe bluaj-i.

Ti, Halim që s'di kendim,
Je vezir për arësim;
Mbyll-i shkollat, se na nxinë
Me kalemin' e tradhëtisë.
Leri hapur medresetë,
Seminaret dhe teqetë,
Po me gjuhët Arabishte,
Hebraishte dhe Gërgishte.

Këtë urdhër çpalle me vrapi:
Libër, ti llaik, mos hap;
M'Ungjillin dhe Kuranin
Merret Prifti me Imamin.

Me këta të dy pastaj
E ujdis Dervish Pasnjaj;
Papazllar' e hoxhal, arë
Janë vllezër të panc'arë.

O Kalam, kaur bekri,
Ty të bëra bash-Myfti;
Çpall: Rakia është e lirë
Për Myslim' e për Qafirë.

O Turgut, o Turk i lik,
Ty të bëra Bash-Patik;
Çpall: Kauri s'merr dot grua,
Se prej Krishtit u-ndalua.

Grat' i marrin kapelanët,
Pashallarët dhe Sultanët;
Dhe kështu bashkohen fetë
Në këtë dhe n'atë jetë.

Kështu thot, Ungjill' i Shenjtë
Për të gjithë të mbëdhenjtë:
I ka bërë Perëndia
Të na zerë llahtaria.

Ti, Selim, Vezir Kusar,
Ruaj arkën me hanxhar;
Sillm'a plot me çdo çare,
Merr dhe ti nonjë meze.

Çelo, hudhër tarator,
Ty të bëra Ambasador;
Qorr Maliq, o martalloz,
Ty të bëra konçolloz.

Ty, Haxhi Domuz evlat,
Ty të bënj Vezir Xhelat;
Lith litar, dhe mpreh sëpatë,
Varrë e ther, po pa shamatë.

Vraj-i, prej-i kundrështarët,
Si të funtmët dhe të parët,
Se m'a prishnë qetësinë,
M'a çkallmuani mbretërinë.

Të pabesët me sevap
Piq-i paq si shishqebab,
Të paudhët me usull
Ziej-i, bëj-i si quill.

Ty, onbash, të bënj bimbash
Shpejt e shpejt, o dinkatdash;
Ty hajdut, të bënj policë,
Vith pa frik' e me shumicë.

Ty, Mazllum, o arkadash
Ty të bëra Akçi-Bash;
Ziej çorbë dhe têrhan
Me tenxher' e me kazan.
Bëj bollgur e bëj pilaf,
Bostantavë, orman-qebap;
Bej-më qoftë dhe çomblek,
Paçe e shqemb' edhe byrek.

Bëj-më dollma me japrak,
Bëj-më kos e kaçamak;
Pi-më mish e pastëрма,
Kavurma dhe kapama.

Bëj-më imam-bajildi,
Kukurec edhe janı;
Mbush një torbë kashkavall
Dhe m'a lith në kapistall.

Bëj-më hallv' e bakllava,
Kadaif e dondurma,
Hyshnjeri, muhalebi,
Teleme dhe revani.

Bëj simit' e bëj kulaç
Bëj lakror e bëj syltiaç,
Petulla për çdo mëngjerez
Plot me mjalt e me pekmez.

Bëj llokum e bëj hoshaf,
Mos çaj kokën për mastraf;
Këtë pun' e ka Hajdari,
Hesapçıu e taksildari.

Mos harro, jam trim dhe ha
Sa një buall dhe një ka;
Pastaj sill-më tri kafe
Dhe dy shishe nargjile.
Si të ha, bej temena,
Ngrer-më një maskara,
Më vendos mi një sofat
Uri'e but' e me rehat.

Gjellët siç i kam gëlltitur
Ler-i, s'duhen kolovitur;
Ndryshe krisa si ruse
Që nga qjelli gjer mi dhe.

Kur të shtrihem, nga çdo anë
Ver-më nga një shishe pranë,
Ver-më kupa dhe meze,
Ndryshe gjumi, or vlla, s'më zë.

Posa të lëshonj shkëndija,
Rentni, zjarr m'u-ndes rakia!
Vala uje shtirmëni
Dhe nga furra nxirrmëni.

Ty, or Hajrullah Sevda,
Ty të bënë Këzllar-Aga;
Ti haremim m'a përbush
Plot me çupa sheg' e rush.

Sill-më lule dhe burbuqe
Qimezeza, qimekuqe,
Ca të vogla, ca të gjata,
Ca të kolme, ca të thata.

Xhan, mos u-çudit me mua,
Që të gjitha nuk i dua;
Që të gjitha do t'i mbleth,
Njëzë vetëm do të zgjeth.
Atë njëzë, or vlla hadëm,
Ty t'a dhashë përt hanëm,
Ty t'a fala si dhuratë,
Sehir bej-e dit'e natë.

Ty të çqepi tirania,
Mua hamja dhe rakia;
Që të gjitha, o Perëndi
Na i bënë me urtësi.

Dhémp na dhe, tërbohemi,
Çkul-e, qetësohemi;
Mënt na dhe, çpikim barut,
Dhe ia shkrepim në tabut.

Na dhe shpatë dhe kerbaç,
Tani gje-na një ilaç;
Se me luftë pritemi,
Digjemi dhe vritemi.

Na dhe brirë mbretërorë,
Na stolise me kurorë,
Na lëshove nëpër dhëntë
Dhe na fluturuan mëntë.

Sill-më, o xhan, dhe nja dy çupa,
Sill-më, o xhan, dhe nja tri çupa;
Eni, çupa, hidhuni,
Shkunduni, përdridhuni.

Eni, zëmtën ngrohmëni,
Eni, mëndjen rokmani.
Zot, nga hyqi s'heqim dorë
Mos bëj dashër me këmborë

"Dielli", 5 Korrik, 1961

E përktheu nga Persishtja Namik Namazi më 17 të Janarit 1961,
dhe e plotësoj sipas një dorëshkrimit që u-zbulua në bibliotekën
e Gollomboçit.

Rudyard Kipling
(1865-1936)

NË MUNÇ (II)

Në munç të mbash në kokë terezinë
Kur shokët çmënder dhe fajtor të nxijnë;
Në munç të kesh besim, kur të dyshon
Kushdo, dhe s'ka njeri që të beson;
Në munç të preç, dhe pritjen s'e kursen,
Në të gënjeftshin, ti nuk i gënjen.
Në të urrefshin, ti s'i çan me brirë,
Dhe s'hiqesh as m'i mënçim as m'i mirë.

Në munç të çndërrosh e të mejtosh,
Dhe nga këto më mos u-robërofsh;
Në munç të preç Triumfin dhe Hatanë,
Dhe t'i shkelmosh të dy si kallpazanë;
Në munç të mbahesh, kur një dreq ta dreth
Të drejtën dhe në lëk sylesh heth,
Kur sheh kalan' e jetës të rëzuar
Dhe prap' e ngre me veglën e çkallmuar;

Në munç të vësh mi grumbull çdo thesar,
Edhe t'i loç të gjitha me një zar,
T'i humpç edhe të nisesh përsëri
Pa thën' asgjë për këtë batërdi;

Në munç të kesh një zëmër, trup e kokë
Që të shërbëjnë sa të bëhen trokë
Dhe të vazhdosh i djegur shkrumëp në furtë,
Dhe të thërrët vullneti: "Mbahu, or burrë!"

Në munç të zbreç në turm' e të mbash r.leria.
Të hash me mbretin, e të pish me ne'erin;
Në mos të ngaftë dor as mik as hasinë,
N'i daç të gjithë, po asnjë për dasin;
Në munç për çdo minutë të përpjetë;
Të renç tamam sekunda gjashtë dhjetë;
Zaptovë dhenë me çdo mall dhe hir,
Dhe ca më mirë, qenke trim, or bir!

"Dielli", 1 Nentor, 1961

E përktheu nga Inglishtja Namik Namazi më 23 Tetor, 1961

Alexis Felix Arvers
(1806-1850)

DASHURIA E FSHEHËT

Në shpirt kam një sekret, në jetë një mister,
Një dashuri pa funt, të kapur në një vrap.
E keqja s'ka derman, pra sheshit nuk e nxjerr,
Dhe ajo që e shkakëtoj s'e mori vesh aspak.

Ajme, kalova pran' asaj i pashikuar,
Përherë afér saj, po i vetëm gjithënje,
Dhe jetën përmi dhenë e kam mbaruar
Asgjë pa lypur fare, edhe pa marrë asgjë.

E ëmb'l e dashur, Zoti siç e ka krijuar,
Vazhdon udhën e staj pa ndjerë e pa dëgjuar
Sevdanë e murmuritur çap për çap kudo.

E lidhur pas detyrës saj të patronditur
Kur të këndonjë këtë vjershë e çuditur
Pyet seç grua qe, dhe s'di të që ish vet' ajo!

"Dielli", 20 Dhjetor, 1961

E përktheunga Fiëngjishja Namik Namazi më 18 Nentor, 1961.

SAGA E SERMAJESË

Jam kusar e jam begar
Dua grua pa zarar.
S'kam para dhe s'gjenj para t'a ble,
Puna duhet bërë me hile.

Dal në breg, bërtas në tym katshi:
"Eja pa! këtej, or çelebi!"
Ardhi, iz tregova meselenë:
"Vem' edhe rëmbejmë Sermajenë!"

Më dëgjoj, më pa në sy,
M'u-përgjegj pa një pa dy:
"Posa dashke dasmë, jam gati,
Sill-na snishen me raki!"

Pim, hërgërm' e u-ngjeshmë
Edhe përsë tu përveshmë.
Un' i hipë kalit,
Dhe ay gomarit;
Kapedan gomati kali kapedan.

Emrin ur' kam Orhan
Dhe ay e ka Turhan.
Unë dhëntër me kurorë;
Ay kumtër me kemborë,

Nus' e bardhë si dëborë,
Në behar pakëzë e zeshkë,
Rumbullike porsi breshkë.
Emrin e ka Sha-Name
Dhe llagapin Sermaje.
Ja vuri syrin Orhani,
U-çudit i tër' Irani;
Kurdistani dhe Afganistani,
Turkestani edhe Hindustani.

Kur u-nismë,
Qe një krismë,
Qe një drithmë!
Kur u-nism' u-tunt dynjaja,
Dhe uerr, u-nxi havaja.

Ja kështu Moskovi u-droth,
Napoloni kur iu-hoth;
Dhe kështu u-myrojt Stalini,
Kur iu-sul Hito Katili
Dhe Benito Mussolini.

De or de, moj mesele,
Ruaju, moj Sermaje,
Sermajeja nukë çante kokën:
Po gërvishte dhe prashitte tokën.

Kruan kokën trim Turhani,
Sé iu-trubullua xhani,
Dhe pyet; "Më thuaj, Orhan Be,
Nusen e bukur ku m'a ke?"

Thot' Orhani: "Ja, atje,
Prapa drizave dhe misrave!"

"Orhan Be më paç, më qafë,
Mos m'a thuaj atë fjalë,
E di mirë këtë arë;
Kjo çsh't ar' e Qor-Hasanit,
E hajdutit, kapadanit,
Që të vret, dhe del i larë,
Se s'ka sy, dhe s'të ka parë."

I mban sytë mbyllur, dhe s'të sheh,
Dhe pastaj, or vlla Orhan,
Njerin sy e hap, dhe merr nishan,
Dhe ja shkrep, e të vret, e s'ke derman.

Syt' i hapën kur qëllon,
Dhe njeri nuk i shpëton.
Ler-e dasmën, hajde shkojmë,
Ikim shpejt, dhe shpëtojmë!
Thot' Orhani: "s'më vret dot askush,
Jam ivrar' edhe i djegur prush!"

Atje ishin, atje imbenë,
E kërkuan dhe e gjetnë;
Sermajeja pret përpara,
Qor-Hasani të vret prapa.

Si babaj edhe e bija;
Ja, mor, dashuria, lebetia!
Dhe kështu, mor u-martuan
Dhe për jet' u-trashëguan.

Dhe e vjeth ajo, s'e vjeth ay
Po ashtu e dashnë që të dy.
Mor kusar, mor budalla,
Kur të vjedhësh, vith para

Ler-i çupat mos i nga,
Mos i merr as badjava,
Se tē kap sevdaja,
Dhe tē mbyt belaja,

De or de, moj mesele,
Rofsh e qofsh, moj Sermaje!

Johan Wolfgang Von Goethe
(1749-1832)

"Dielli", 27 Mars 1963

E përktheu nga Persishja Namik Namazi, Ishpakan, Shkurt
II, 1963.

1. QETËSIA

Përmi çdo majë mali
Ka qetësi:
Mi asnjë majë mali
Asgjë s'lëvis,
As pipëtin;
Në pyllin zoqt' e vegjël po pushojnë:
Prit pak, se shpejt a vonë
Gjen qetësi dhe ti.

2. VIJA (The Brook)

Moj vij' e kthjell' e kjart' ergjend,
Ngaherë rent nga vënd në vënd
Në breg qëndronj dhe po mejtonj:
"Nga po më vjen, ku po më shkon?"

"Vinj prej një burgu shkëmp greminë
Rjeth nëpër lule dhe lëndinë,
Qjellin e kaltër bukuri
E pasqyronj me dashuri."

3. KËNGA E NATES

Që nga jastëku i butë i qendisur
Dëgjo-më pak, kur éndërronj
Kur los vjolinë e zhuritur;
Fli! Tjatër gjë, mor xhan, ç'kérkon?

Kur los vjolinë i zhuritur,
Tabor' i yjve m'a bekon
Çdo ndjenjë lart nga qjelli i zbritur;
Fli! Tjatër gjë, mor xhan ç'kérkon?

Çdo ndjenjë lart nga qjelli zbritur
Më ngre përpjet' e më shpëton
Nga zhurm' e dheut e mérzitur
Fli! Tjatër gjë, mor xhan, ç'kérkon?

Nga zhurm' e dheut e mérzitur
Më shqit edhe më lumeron,
Më fal mëngjsen' e alladitur.
Fli! Tjatër gjë, mor xhan, ç'kérkon?

Më fal mëngjsen' e alladitur.
Për gjumë n'ëndërr më dëgjon
Ah, nga jastëku i butë i qëndisur;
Fli! Tjatër gjë, mor xhan, ç'kérkon?

4. I PERËNDISHMI

Vetën njeriu ka në dorë
Të bënje të pamunduren;
E ndërr të bardhën nga e zëza,
Zgjeth e gjykon;
Di dhë zejeron,
Çastin e vogël e madhon.

Vetëm aty ka zotësi
Të mirin t'a çpërblenjë,
Të ligun t'a dënonjë;
Të shëronj' e të shpëtonjë,
Të bushkonjë për shërbim
Të lajthiturit e t'arratisurit.

Kështu pra, i nderojmë
Ata që janë të pavdekur
Sikur të ishin njerës,
Sikur të kenë bërë madhërisht
Atë që më i miri vogëlisht
Ka bërë e ka dëshëruar.

Burri bujar duhet të jetë
Gait për ndihmë dhe i mirë;
Duhet të jetë i palodhur
Për shërbim e për të drejtë;
Duhet të jetë një pasqyrë
E Shpëtimtarit që po éndërojmë.

"Dielli", 12 Qershor, 1963

I përktheu që të katra nga Gjermanishtja Namik Namazi 27-30.
5.1963

Heinrich Heine
(1797 - 1856)

GRENADIRËT E NAPOLEONIT

Për Franc' u-nisnë të dy grenadirët;
Na ishin zënë robër në Rusi
Dhe në kufi të *Nemces* kur arrinë
Kokën e varrn' e zunë vaj e zi.

Dëgjuan lajmën q'u-pikoj në xhan
Që Franca ish e humbur plotërisht,
Q' Asqer i Math ish mundur mor aman,
Dhe Mbreti or Mbreti na u-zu jesir.

Ahere qanë hidhur grenadirët
Kur muarnë mandatën pér vajtim;
Dhe njëri tha: "Ajme, zëmra më çiret,
Më ther një plag' e vjetër pa shërim!"

Dhe tjatri tha: "Havazi mori funt!
Një lloj të vdes me ty dhe unë dua,
Po kam foshnj' e grua në katunt
Dhe do të mbeten udhëve pa mua."

"Or mall s'të kam pér foshnj' e grua plakë,
Kam një dëshirë më të lart, or bir;
Ngorthçin të gjithë rugës liparakë,
Kur Mbreti or Mbreti na u-zu jesir.

"Këtë dëshirë m'a mbaro, or vlla,
Nëqoftëse tanë të le shëndet:
Trupin m'a shpjerë në Francë, në vatan,
Në Francë më mbulo me saltanet,

"Kryqin kordhellë-kuq, nishanin tim,
M'a varr, të lutem, përmë zëmrën time,
Dhe në të djathtën nem dyfekun tim,
Edhe në brezin ngjish-më shpatën time.

"Kështu pra, do të shtrihem, do të pres
Në varr si në kaushin gardian
Gjer ditën kur topi gjëmon, kërcet,
Dhe kali hingëllin mi çdo dushman.

"Ahere Mbreti më kalon mi varrin,
Këllëcet, vetëtijn' edhe kërcasin;
Dhe un' i armatosur dal nga varri
Dhe Mbreti or Mbreti empronjë mos m'angasin."

"Dielli", 19 Qershor, 1963

Charles Pierre Baudelaire
(1821 - 1867)

KAPAKU I TENXHERES

Kudo që vete nöpér tok' e nöpér det.
Ku klima ngroh, e djelli tē ngrin mynxyrë.
Dishepull i Jesuit, a derr pa selamet.
Lipës i humbur, a miliunar i fryrë.

Pshatar a qytetar, i çkafët, a tembel,
Me trurin që lëvrin, a që gërrët e fle,
Njeriu, lëmsh prej një mysteri teveqel.
Më kot përpjet' i drithëruar syt, i ngre.

Dhe qjelli si kube qëndron prej shpelle guse,
Tavam i ndritur prej një operaje bufë
Ku çdo xhambaz mi pellk prej gjaku po kërcen.

Përmëkatunin me, mërmugun shpës' emumme,
Qjelli kapak po e mbulon tenxheren zhumë
Ku e padukur njerëzi' e zezë zjen.

"*Dielli*", Qërvor 26, 1963

Përktheu nga Frëngjishtja Namik Namazi më 6/10/1963.

Leib Neidus
(1890-1918)

E DUA PYLLIN

E dua pyllin e përpjetë
Q'arrin ne qjell ku djelli ndrit;
Ah jo, jo pyllin, po patekën
Që përmes pyllit më shetit.

Dua patekën që ka vetëm
Ca lule t'egra dhë ca gjëmbë;
Jo, jo patekën, po shtëpin e shkretë
Ku shpie kjo patekë brënda.

Dua shtëpin' e gjelbëruar
Në mes të pyllit si kuvli;
Jo, jo shtëpinë, duar zogën,
Një vajzë q'atje brënda rri.

"*Dielli*", 3 Korrik, 1963

E përktheu nga Jiddishtja Namik Namazi më 5/28/1963.

William Knox
(1789-1825)

KOTËSIA NJERËZORE

Përse njeriu është kryelartë?
Si re e shpejtime, mctcor i zjartë,
Si dritë vetëtin si valë na vëngon,
Ngajeta në pushim, në varr kalon.

Nga dushku dhe nga shelgu bje çdo fletë,
Pérndahan rotull, shtrihen tatëpjetë,
Të vogla, të mëdha, të ra, të thata
Përmbysen tok dhe hidhen në gërmadha.

Kurora e një kokë mbretërore
Me mitrën dhe krabën priftërore,
I dituri dhë trimi zëmërmath
Mbërthehen në qivur, zbresin në varr.

Cdo shpresë, dëshpërimi, helmi gazi
Çkallmohen nga tufani dhe porjazi,
Çdo lot e buzëqeshje, vaj e valle
Dërmohen porsi vala nëpër zalle.

Shkëndij' e syrit edhe frym' e jetës,
Lul, e shëndetit, edhe shkrumb' i vdekjes,
Rëzohen në savan nga kulm' i artë:
Pra, qysh njeriu është kryelartë?

"Dielli", 14 Gusht, 1963

Chidiock Tichborne
1558-1586

Chidiock Tichborne
(1558-1586)

NË VENGJILLËN E VDEKJES

Lul' e rinisë m'u-bë pellk merakeshi.

E kreml' e gazit m'u-bë vurk mëkatesh
Gruri që korra dolli ergj' e therine.

E tër' e mira imë dolli shpres' e vierme,
Dit' më shkoj, dhic dielli; s'e pashë,
Tani po rronj, tani jetën e lashë.

Halli m'u-duk, po unë nuk e çfaqa,
Pema më ra, po fleta s'm'është tharë,

Rinin' e kam mbartar, po s'u-mplaka.

E pashë botën, bota s'më ka parë,
Peri m'u-pre, po i patjerur rashë,
Tani po rronj, tani jetën e lashë.

Kërkova vdekjen dhe në zemr' e gjeta,
Kam dashur jetën dhe kufomë mbeta,
Barita tokën, varrin tim e miha.
Tani po vdes, kur jetën time nisa,
Kupa m'u-mbush, tani m'u-zbras, u-vrashë,
Tani po rronj, tani jetën e lashë

"Dielli", A Shtator, 1963

Shënim:

Albumi u botua në 1948 me këtë shënim në frontespic:

Albumi

*Dyzetëvjeçar në Amerikë
1906-1946
I Hirësisë Tij
Peshkop Fan S. Noli*

*E botoj Federata Vatra.
Boston, Massachusetts,
- 1948*

Fleta e dytë mban përkushrimin:

KRYETRIMAVE

*QE F. ÇLIRUAN SHQIPÉRINË
NGA FASHISTËT
NGA NAZISTËT
NGA BEJLERËT
U DEDIKOHET KY ALBUM
PREJ FEDERATES
VATRA*

Meqenëse ky është një botim jubilar, me rastin e 50 vjetorit të botimit të parë të *Albumit*, ruajtëm të pandryshuar ortografinë e kohës, si pér kritikën, parathënien dhe shënimet e tjera të lëna nga Noli, apo ato shënime që gjenden në botimin e *Vatrës*. Nuk janë përfshirë *footnote-t* mbi leksikun që spjegojnë turqizmat, huazimet, emrat e personazheve mitologjikë e biblikë si, shënimet me karakter biografik mbi autorët e përkthyer, komentet filologjike etj. Janë shënuar datat e krijimit të poezieve apo përkthimeve, kur ato gjenden, si dhe datat dhe emrat e gazetave ku kjo krijimtari u botua pér herë të parë.

Në këtë botim janë përfshirë edhe ato lirika e shqipërime të Nolit që nuk i kishte "*Albumi*" botuar më 1948 në Boston. Lirikat e shqipërimeve e shtuara janë nxjerë nga *Albumi*, Tiranë 1958, mbledhur e redaktuar nga Vebi Bala. Gjithashtu, pér disa saktësime datash e botimesh, jemi konsultuar me botimin akademik "*Fan S. Noli - Vepra I*" - Tiranë 1987, redaktuar nga Nasho Jorgaqi dhe botimin "*Fan S. Noli - Albumi*", Rilindja, Prishtinë - 1968, me redaktor bibliotekë Ali Rexha.

"*Albumi II*" përfshin vjershët e Nolit botuar në gazeten "*Dielli*" 1961-1963, të cilat i mbledhi e përgatiti pér shtyp Qerim M. Panariti, botuar në Boston 1966.

PËRMBAJTJA

Poeti Fan S. Noli 5

ALBUMI

1. Liriket

Hymni i flamurit	27
Thomsoni dhe kuçedra	28
Jepni për nënën	30
Moisiu në mal	32
Marshi i Krishtit	34
Krishti me Kamçikun	36
Shën Pjetri në mangall	38
Marshi i Barabbajt	40
Marshi i kryqësimit	42

Kirenari	44	Dashuria e Fshehet	131
Kryqesimi	48	Saga e Sermajesë	132
Kënga e Salep-Sultani	49	1. Qetësia. 2. Vija (The Brook)	136
Syrgjin - vdekur	51	3. Kënga e natës	137
Shpell' e Dragobisë	52	4. I perëndishmi	138
Rent. or Marathonomak!	54	Grenadirët e Napoleonit	139
Anës lumenjve	57	Kapaku i Tenxheres	141
Plak, topall, dhe ashik	60	E dua pyllin	142
Sofokliu	62	Kotësia Njerëzore	143
Frym moj erë	63	Në Vengjillën e Vdekjes	145
		<i>Shënime</i>	146

II. Shqipërimë

Skënderbeu	69
Nga "Prometheu i mbërthyer"	75
Nga "Hamleti"	77
Nga "Othello"	81
Nga "Don Kishoti"	82
Nga "Rubairat"	86
Korbi	92
Annabel Lee	99
Asaj që shkoi	101
Jctimi	102
Dashuria e funtme	103
<i>Biografia e Peshkop Nolit</i>	10

ALBUMI II

<i>Parthénie</i>	109
Lule mi varr	112
Vajtim për Bijen	113
Waterloo	119
Sulltani dhe Kabineti	122
Në Munç (IF)	129

FAN S., NOEL

Albumi
Shtëpia Botuese "Naim Frashëri"
Tirane 1998

tirazhi 1000

ISBN 99927 38 01 4

ISBN 99927 38 01 4

